

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7376 E enjte 7 Dhjetor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Nga BERND BORCHARDT

**P**ara pak muajsh, disa qytetarë shqiptarë bënë një demonstratë për të shprehur indinjatën në lidhje me vendimin për prishjen e shtëpive të tyre që ...

Vijon në faqen 20

Roli i ndërkombëtarëve në tranzicionin e Shqipërisë



Opinion

Ditës

Nga ANDON ANDONI

**U**ndodha këto ditë në fshatin tim të lindjes, në Ziçisht, teksa disa nga banoret gra, në moshë, së bashku me fëmijët e shkollës, kishin dalë derë më derë, për të firmosur ...

Vijon në faqen 21

Shkolla njëqindvjeçare, drejt mbylljes.



Ja kush përfiton, fondi 1.8 milionë lekë

## Festat e fundvitit, pensionistët do të marrin 3 mijë lekë shpërblim nga qeveria

Kësti i 8-të për ish-të përndjekurit, pagesat për kategoritë prioritare

Nga ORNELA MANJANI

Qeveria do t'u japë rreth 3 mijë lekë pensionistëve për festat e fundvitit. Për pensionistët përfitues është vënë në dispozicion një shumë prej 1.8 miliardë lekësh. Fondi është miratuar si një nga zërat e aktit ...

Në faqen 6

**VENDIMI I QEVERISË: 70 PËRFITUES MARRIN KOMPENSIM NE TE GJITHE VENDIN**

# ALUIZNI: 1200 PRONARE MARRIN TAPITE E TOKAVE

Vendimi i qeverisë për kalimin e pronësisë dhe shpronësimet. Lista e plotë me emrat e pronarëve të hershëm dhe të rinj që përfitojnë...



(Në foto) Ndërtime informale në proces legalizimi

Në faqen 16-19

HISTORIA



**U arrestua si gylenist, nëna: Djali do botonte një libër, martesë**

Në faqen 9

Flasin pacientët: Është kaos, janë pak mjekë për shumë njerëz

## Urgjenca, dorëhiqen dhe 4 mjekë të tjerë

Shkon në 12 numri i bluzave të bardha që nënshkruan petitionin

Nga VOLTIZA DURO

**E**dhe 4 mjekë të tjerë të Urgjencës Qendrore në QSUT kanë firmosur ditën e djeshme letrën e dorëheqjes kolektive si pasojë e kushteve të rënda të punës. Burime konfidenciale nga urgjenca, bëjnë me dije për "Gazeta Sh-



qiptare" se mjekët me iniciale L.Ç, P.P, B.H dhe R.P i janë bashkuar 8 kolegëve të tyre dhe janë solidarizuar në lidhje me këtë situatë. "I vetmi që nuk ka firmosur këtë petition, është shefi i urgjencës, Edmond Zaimi, ndërkohë që jemi plot 12 mjekë ...

Në faqen 11

MBESHETJA

**Ikja e Liallës, Rama: Tryezë për Kryeprokurorin, për 6 muaj negociata për BE**

Në faqen 3

BISEDIMET

**Meta takon Prodin:**

**Duhet reagim shumë i fortë, ndryshim i dukshëm**

Në faqen 5

DROGE PER NE ITALI

**Zbardhet skema e kalimit të 2.5 tonëve kanabis, si u përfshinë policët**

Në faqen 7

ZEVENDESIMI I DUKES

**Zgjedhjet te Filologjiku, kush garon për postin e Dekanit, detajet**

Në faqen 14

# KRYEPROKURORI REAGIMET

Publikimi i memos për pasuesin e Lllallës detyron "Ligjet", ta fusin në rend dite

## Zbardhet dokumenti, zgjidhet me 84 vota Kryeprokurori i ri


Procesi i zgjedhjes, këshilla e DMIP për Kuvendin

Valentina Madani

Prokurorit të Përgjithshëm Adriatik Lllalla sot i mbaron mandatin, ndërsa parlamenti do të nisë zyrtarisht procedurën për zgjedhjen e pasuesit të tij. Çështja e Kryeprokurorit ka vënë përballë mazhorancën dhe opozitën. Teksa shumica ka shprehur qëndrimin e saj për zgjedhjen e një kryeprokurori të përkohshëm me 71 vota deri në ngritjen e KLP, opozita është shprehur kundër këtij qëndrimi. Ndërkohë, gjatë ditës së djeshme u publikua në media një memo e Drejtorisë për Monitorimin e Institucioneve të Pavarura në Kuvend që shpreh qëndrimin se Kryeprokurori duhet të zgjidhet me 84 vota. Zbardhja e memos ka detyruar Komisionin e Ligjeve që sot ta fusë në rendin e ditës. Memoja e Sekretariatit të Përgjithshëm të Kuvendit, e protokolluar më datë 21 nëntor, do të futet sot në rendin e ditës me relator Bledi Çuçin, për miratimin e procedurës së caktimit të përkohshëm të Prokurorit të Përgjithshëm. Ndërsa mazhoranca shpresonte ta zgjidhte Kryeprokurorin e ri me 71 vota, DMIP këshillon zgjedhjen me 84 vota, duke kujtuar se mbi gjithçka prevalon Kushtetuta. Në memon e Kuvendit dërguar Komisionit të Ligjeve sqarohet qartë se Kryeprokurori i ri duhet të zgjidhet me 3/5, pra me 84 vota. Në të thuhet se prokurori i ri nuk mund të zgjidhet me shumicë të thjeshtë. Në dokument theksohet se nga muaji mars dhe deri tani ka rezultuar se në kandidatëve që i janë përgjigjur thirrjeve ka rezultuar nën minimum ligjor dhe për këtë arsye është rishpallur thirrja për kandidat. "Në mbështetje të dispozitës kalimtare të nenit 179 të Kushtetutës së amenduar me ligjin 76, 2016 pika 13 e tij, sipas të cilit parashikohet se deri në zgjedhjet parlamentare që do të mbahen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, por jo më vonë se data 1 shtator 2017 zgjedhje e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm do të bëhet me 2/3 e anëtarëve të Kuvendit, zgjedhje të tjera do të bëhen me 3/5 e anëtarëve të Kuvendit. Në respektim të hierarkisë së normës juridike, Kushtetuta dhe ligji nr.97/2016 dhe Rregullores së Kuvendit nën 55 pika 1, ligjet, vendimet, deklaratat dhe rezultatet konsiderohen të miratuar nga Kuvendi, kur për të kanë votuar shumica e deputetëve në prani të më



Prokurori i Përgjithshëm Adriatik Lllalla



Faksimile e memos së DMIP

shumë se gjysmës dhe gjithë anëtarëve të Kuvendit, me përjashtim të rasteve kur në Kushtetutë parashikohet shumicë e cilësuar për miratimin e tyre. Miratimi nga Kuvendi i vendimit për caktimin e Prokurorit të Përgjithshëm të Përkohshëm duhet të kryhet në respektim të këtyre dispozitave", thuhet në memo.

Lidhur me këtë dokument, mësohet se Komisioni i Ligjeve ndryshoi rendin e ditës dhe ka caktuar për të enjten një seancë për diskutimin e memos. Mbledhja e sotme hap kështu procedurat për Kryeprokurorin e ri. Për mazhorancën, deri në ngritjen e KLP-së, do të hyjnë

në lojë dispozitat kalimtare të Kushtetutës, që kërkojnë një Prokuror të Përgjithshëm të Përkohshëm, që përbush kriteret ligjore me një votim të thjeshtë prej 71 votash, sikurse sugjeron EURALIU dhe OPDAT. Nga ana tjetër, kundërshtimit të opozitës i është shtuar edhe Kuvendi.

### Dorëheqjet, zbardhet vendimi i "Kushtetueses"

## Gjyqtarët mund të ruajnë pasuritë edhe pas vetingut

Gjykata Kushtetuese zbardhi vendimin se si do të veprojë me procesin e vetingut dhe dorëheqjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Edhe gjatë procesit të vetingut ku do të kontrollohet pasuria, ana profesionale dhe integriteti moral, gjyqtarët dhe prokurorët mund të japin dorëheqjen dhe ky proces të ndërpritet. "Gjykata thekson se për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës", thuhet në vendim. Sipas ligjit 84/2016 në nenin 56 të tij përcaktohet: "1. Subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të japë dorëheqjen nga detyra jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Dorëheqja i paraqitet me shkrim Presidentit të Republikës dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni. Në rastin e dorëheqjes, Komisioni merr vendim për pushimin e procedurës së rivlerësimit. 2. Pas dhënies së dorëheqjes, subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të përfillojë pagesë kalimtare, sipas nenit 7, pika 1, të ligjit "Pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit". Me këtë vendim, Gjykata Kushtetuese i njeh të drejtën të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve, të cilët janë duke u nënshtruar vetingut apo zgjedhjen të shmangin vetingut të dorëheqjen në çdo moment. Në rast se sipas nenit 56/2017 gjyqtarët dhe prokurorët, të cilët do të jepnin dorëheqjen, tre muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit, gjyqtarët dhe prokurorët do të përfitonin pagesë kalimtare, tashmë ata do të dalin jashtë sistemit për 15 vite dhe s'do përfillojnë pagesë kalimtare.



simi ka të drejtë të përfillojë pagesë kalimtare, sipas nenit 7, pika 1, të ligjit "Pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit". Me këtë vendim, Gjykata Kushtetuese i njeh të drejtën të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve, të cilët janë duke u nënshtruar vetingut apo zgjedhjen të shmangin vetingut të dorëheqjen në çdo moment. Në rast se sipas nenit 56/2017 gjyqtarët dhe prokurorët, të cilët do të jepnin dorëheqjen, tre muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit, gjyqtarët dhe prokurorët do të përfitonin pagesë kalimtare, tashmë ata do të dalin jashtë sistemit për 15 vite dhe s'do përfillojnë pagesë kalimtare.



Gjatë një seance parlamentare

### MANDATI

Elena Xhina merr zyrtarisht mandatin e deputetes së PDIU-së pas dorëheqjes së Bujar Muçajit. KQZ në mbledhjen e djeshme vendosi t'i japë mandatin e deputetit kandidatit të radhës së listës shumë emërore të subjektit "PDIU", qarku Elbasan, Elena Xhina.



Deputeti Enkelejd Alibeaj

## Arrestimi i policëve për trafik droge, Alibeaj: Duhet qeveri antimafie

PD përmes deputetit Enkelejd Alibeaj akuzoi dhe kryeministrin Edi Rama dhe qeverinë se t'ij si të implikuar me bandat kriminale. Duke marrë shkas nga kamioni që u bllokua në portin e Durrësit me 2.5 tonë kanabis, ku ishin të përfshirë 3 punonjës policie, Alibeaj në emër të PD-së theksoi se opozita ka denoncuar në shumë raste implikimin e punonjësve në trafikun e drogës. Alibeaj tha se Rama është arkitekt i kësaj politike makabër. "Për 2.5 tonë kanabis të dala nga porti i Durrësit ishin të përfshirë 3 policë, dy të Durrësit dhe një i Fierit. PD e ka denoncuar prej 4 vitësh kriminalizimin e policisë. Kjo qeveri nuk jep asnjë garanci se krimi të mund të luftohet. Nuk ka si të ndodhë dhe as të shpreshet se mund të ndodhë, pasi Rama është ideator, arkitekti dhe ekzekutori i këtij krimi makabër për të kriminalizuar policinë. Nuk mund të japë asnjë garanci, kur vetë vëllai i Xhafajt është i hetuar, i proceduar, i dënuar nga të gjitha shkallët e gjykimet në Itali për trafik lëndësh narkotike heroinë dhe kokainë. Siç shpeshohet për luftë ndaj krimit, kur ish-ministri Tahiri, i zhytur në këtë vorbull u mor në mbrojtje nga Rama. E nuk ka se si të ketë shpresë që shteti të luftojë krimin kur 3 zyrtarëve iu krijuan kushtet dhe lehtësisi për t'iu shmangur drejtësisë. Rama po bën çdo përpjekje për të marrë nën kontroll të gjitha organet e drejtësisë, përfshi edhe kryeprokurorin. Ai po bën vetë kriminelin, policin, prokurorin. Sot më shumë se kurrë është nevojë imediate, krijimi i një qeverie antimafie. Duke nisur së pari nga largimi një orë e më parë të Edi Ramës", tha Alibeaj.



Kryeministri kthehet nga Brukseli, i paraqet opozitës propozimin e ri

# Rama: Tryezë për Kryeprokurorin, Pakt Kombëtar për Evropën që duam

"Në 6 muajt e ardhshëm të sigurojmë negociatat"

Darina Tanushi

Kryeministri i vendit, Edi Rama, i sapokthyer nga Brukseli i propozoi mbërme opozitës të zgjidhin me marrëveshje çështjen e zëvendësimit të Prokurorit të Përgjithshëm. "A mund të kemi një zgjidhje të përbashkët për Prokurorin e Përgjithshëm, si pikënisje të një Pakti Kombëtar për Evropën që duam?", -ngriti mbërme pyetjen Rama. Sipas tij, "Shqipëria është në vigjilje të një takimi me historinë, sepse në gjashtë muajt e ardhshëm do të vendoset nëse do t'i çelim dot apo jo negociatat për anëtarësimin me Bashkimin Europian; nëse do të ngjijm një shkallë themelore vlerësimi ndërkombehtar për vendin tonë, e për rrjedhojë edhe pjekurie të re në sjelljen politike ndaj atdheut tonë të përbashkët, apo nëse do ta humbasim këtë shans historik për t'u afruar më shumë se kurrë më parë me Bashkimin Europian; nëse do të punojmë të gjithë, së bashku, për ta fituar shtidën e çeljes së negociatave apo do ta humbasim edhe për fajin tonë, takimin me historinë". Duke vënë në dukje se vendi është shumë afër kësaj mundësie, Rama u shpreh se këtë e konfirmoi edhe vetë Presidenti i Komisionit, Jean-Claude Juncker, deri dje i heshtur në raport me Shqipërinë. "Por, gjithashtu, po kemi ende shumë për të bërë, që distancën e shkurtuar tanimë maksimalisht, ta zerojmë në këta gjashtë muajt duke u përballur të bashkuar, centimetër për centimetër, deri me skeptikun më të fundit në rreshtin e gjatë të vendimmarrësve europianë. Dhe nëse këtë copë rrugë deri në qershorin 2018, e bëjmë të ndarë si deri më sot, me qeverinë që flet në emër të vendit e me opozitën që bën politikë të brendshme kur flet me faktorët jashtë vendit, rrezikojmë që të ngatërrohim me këmbët tona në centimetra të fundit dhe pastaj, eh, pastaj të detyrohemi të presim kushedi sa kohë që të na riparaqet mundësia historike", -tha më tej, kryeministri. "Nuk dua të bëj asnjë gjyq publik të qëndrimit të derisotëm të opozitës, sepse nuk e kam gjëkundë qëllimin të tregoj këtu pse ne po bëjmë gjënë e duhur për vendin, teksa opozita po



Kryeministri Edi Rama

European. Unë i di mirë besoj pikat ku opozita ndahet me ne, po besoj e di mirë edhe çdo përfaqësues i opozitës që ka lidhje me partnerët ndërkombëtarë, se ata nuk e aprovjnë ekspozimin në gjuhë të huaj të dasisë së egër të politikës tonë të brendshme. Dhe jo vetëm nuk e aprovjnë, por ka ndërta që e përqeshin dhe e përdorin si argument, për ngurrimin e tyre të brendshëm që të aprovonjë çeljen e derës së negociatave për Shqipërinë", -u shpreh më tej, Rama. "Natyrshisht opozitës nuk i kërkon kush që të heshtë, aq më pak mund të më shkojë mua në mendje diçka e tillë. Çka unë i kërkoj opozitës është të konsiderojë pa humbur kohë ftesën që të ulemi në tryezë për çështjen aktuale të Prokurorit të Përgjithshëm dhe të bëjmë një Pakt Kombëtar për Evropën që duam. Të thjeshtë, të qartë dhe seriozë. Me disa hapa të përbashkët drejt çeljes së negociatave (dhe pse jo edhe përtej nëse ka mundësi në rrugën e arsyes), si shprehje e vullnetit të mirë për ta vënë Shqipërinë mbi partitë dhe axhendën e përbashkët kombëtare mbi axhendat e përvëçme të politikës së ditës", - ishte ky propozimi i Ramës. "Kjo do të ishte rruga më e arsyeshme për të mos përdorur kartonët e shumicës së thjeshtë në çështjen e Prokurorit të Përgjithshëm dhe për të mos i lënë asgjë mangët përpekjes për t'i çelur negociatat për anëtarësimin, të cilat kësaj, do të ishin një fitore e madhe e vendit në arenën ndërkombëtare, një fitore e madhe e politikës në tërësi dhe e asnjë pale në veçanti, një fitore e madhe e të gjithë shqiptarëve pa dallim", - e mbyll komentin e tij Rama.

## Rama në Poloni: Linjë ajrore direkt

### Kryeministrja polake: KE do të njohë progresin në Shqipëri

Kryeministri Edi Rama, pas Brukselit ishte dje, në Poloni, ku u prit në Varshavë, nga homologia, Beata Szydlo. Në një konferencë të përbashkët për mediat, kryeministrja Rama u shpreh: "Me kryeministrin kemi ndarë plotësisht mendimin se ka një potencial të madh të pasfrytëzuar për zhvillimin e marrëdhëniet tona ekonomiko dhe tregtare". "I kam kërkuar kryeministres që të inkurajojë kompaninë e fluturimeve polake për të konsideruar mundësinë e vendosjes së një linje direkte, e cila patjetër do të sillte përfitueshmëri të lartë dhe reciproke në këtë drejtim", -u shpreh Rama. Nga ana e saj, kryeministrja polake tha se të dy qeveritë do të vazhdojnë të punojmë, të eksplorojnë mënyra të reja bashkëpunimi për thellimin e mëtejshme të kësaj marrëdhënieje. Ajo u shpreh se me kryeministrin shqiptar kanë biseduar edhe "për punën e përbashkët në përgatitjen e Shqipërisë për procesin e negociatave të anëtarësimin në Bashkimin Europian". "Jemi të gatshëm të ndajmë të gjithë këtë përvojë me Shqipërinë, teksa kam, po ashtu, shpresën se Komisioni Europian do të njohë progresin e bërë nga Shqipëria, duke përcaktuar një datë të qartë të fillimit të negociatave. Shprehja gatishmërinë time për të asistuar Shqipërinë edhe në reformën të tjera kyce, si ajo në administratën publike", -tha Beata Szydlo.



bën gjënë e gabuar duke e goditur vendin në gjuhë të huaj. Dua vetëm të arsyetoj ftesën publike për opozitën që, të paktën në gjashtë muajt e ardhshëm, t'i vihem në dispozicion së bashku përpekjes për të siguruar çeljen e negociatave, duke bashkërenduar nismat e veprimet e nevojshme për ta çuar jo qeverinë, po Shqipërinë në fitoren e kësaj sfide të vështirë, por krejtësisht të mundur tanimë", - theksoi Rama.

### PROPOZIMI

"Momenti kur diskutohet për mandatin e Prokurorit të Përgjithshëm, është, sipas meje, momenti i duhur për të diskutuar, jo thjesht daljen nga situata e fundmandatit të prokurorit në detyrë dhe hyrjen në fazën e një mandati të përkohshëm me një prokuror të përkohshëm, po nisjen e një faze të re bashkëpunimi mes qeverisë e opozitës në vigjilje të vendimit për çeljen e negociatave të Shqipërisë me Bashkimin

## Qeveria



### MBLEDHJA

Qeveria pritet të zhvillojë mbledhjen e saj, këtë fundjavë në qytetin e Shkodrës. Gjithashtu, po në Shkodër do të mbledhet edhe Këshilli Kombëtar i Territorit, ku do të miratohet plani kombëtar i Alpeve.



Ministri i Jashtëm Ditimir Bushati është takuar në Bruksel me homologun grek, Nikos Kotzias

## Ministri grek pritet të vizitojë Tiranën

### Samiti i NATO-s, Bushati takon Kotzias në Bruksel

Ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, Ditimir Bushati është takuar në Bruksel me homologun grek, Nikos Kotzias. Këtë e zbuloi vetë ministri shqiptar i Punëve të Jashtme, përmes postimit të një fotoje në rrjetin social. Takimi i dy ministrave është bërë në kuadër të takimit të ministerialit të NATO-s. Ky është takimi i dytë në pak javë pas atij në Kretë. Ministri i Jashtëm grek, Nikos Kotzias do zhvillojë një vizitë zyrtare në Shqipëri me ftesë të Bushatit në muajt në vijim, pas takimit dy ditor të Kretës ku u diskutuan çështjet që mbajnë larg dialogun mes dy vendeve si Ligji i Luftës, marrëveshja e detit, Çamëria dhe minoriteti grek në Shqipëri.

### PERMBARUESI GJYQESOR PRIVAT ERMIR GODAJ

Permbaruesi gjyqësor privat Ermir Godaj zhvillon ankandin e pare për shlyerjen e pasurise se pakajshme "Tirali me sipërfaqe 206 m², nga të cilat 206 m² Ndertesë, me Nr. Pasurisë 554/3, Vol.5, Fq.183, Z.K.3070, e ndodhur ne Puke", e lene kolateral per garantimin e kredise, per shlyerjen e detyrimit ne favor te kreditorit ProCredit Bank Sh.a., per shumen 1'822'310.51 (nje milion e loteqind e njzetete e dy mije e treqind e dhjete pike pesedhjetete e nje) Leka. Çmimi filluesar me të cilin lilon ankandi është ne shumen 1'354'656 (nje milion e treqind e pesedhjetete e kater mije e gjashteqind e pesedhjetete e gjashte) Leka. Ankandi zhvillohet ne date 18.12.2017, ora 16.00 ne zyrën e përmbaruesit gjyqësor privat Ermir Godaj, Rruga "Abdi Topçani", qendra Torre Drin, nr.42, nr.33, Tirane, dhe per informacion mund te kontaktoni ne nr.0682099471, 0684054605, email ermrigodaj@zyraprmbarimit.com.

# REFORMA NE DREJTESI KUVENDI

Valentina Madani

Gjykata Kushtetuese, Gjykata e Lartë, Prokuroria e Përgjithshme dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë kanë dërguar emrat e kandidatëve për shortin që do të hidhet sot për të përcaktuar anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Shorti do të hidhet nën drejtimin e nënkryetares së Kuvendit, Vasilika Hysi. Por opozita e kundërshton, duke kërkuar ndërprerjen e menjëhershme të procedurave si shkelje të Kushtetutës për zgjedhjen e kandidatëve nga institucionet kryesore të drejtësisë, Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Administrative si dhe Prokuroria. Me anë të një letre drejtuar kreut të Kuvendit, Ruçi, kryetari i grupit të PD-së Edmond Spaho akuzon se kryetari i Kuvendit po shkel Kushtetutën me shortin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. "Gramoz Ruçi po realizon procesin në boshllëk ligjor. Ai po bën ndërhyrje në kompetencat institucionale të pavarura dhe po u dikton institucioneve të pavarura vullnetin e PS", thuhet në reagimin e PD-së. "Konkluzioni i parë është se kryetari i Kuvendit ka vepruar në kundërshtim flagrant me kompetencën kushtetuese dhe ligjore duke, u diktuar organeve të pavarura zbatimin e deformuar të ligjit. Kryetari i Kuvendit u ka kërkuar institucioneve, Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Prokurorit të Përgjithshëm, Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë të hartojnë listat e kandidatëve për KED, duke u bazuar tek neni i Kushtetutës, që përcakton masën disiplinore si kriter të vetëm për kandidatët. Kryetari i Kuvendit ka shmangur kriteret ligjore, të zbatuara për shortin e janarit 2017 nga të gjitha institucionet e pavarura. Ligji përcakton 8 kriteret për kandidatët, duke rritur cilësinë e tyre. Mes kriterëve është edhe përfundimi i Shkollës së Magjistraturës", thuhet në letër e PD-së. Më tej në letër citohet: "Ndryshimi i paligjshëm i rregullave të lojës në mes të procesit është i papranueshëm dhe në kundërshtim me parimin e shtetit të së drejtës. Ndryshimi i këtyre rregullave, për shkak të përshatjes me vullnetin e njëanshëm të mazhoracës, përbën haptazi tentativë për të ndikuar në përbërjen e KED-së, me qëllimin final, garantimin e kontrollit politik nga mazhoranca mbi këtë organ të pavarur kushtetues dhe nëpërmjet tij në Gjykatën Kushtetuese dhe Inspektoratin e Lartë të

Zbardhet lista, cilët janë kandidatët për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi

## Shorti, PD ultimatum Ruçit: Ndërprit procedurat, po shkel Kushtetutën!

LSI: Procesi është i pavlefshëm ligjërisht



Hedhja e shortit për organet e vetingut në kuvend

### SHORTI

Kuvendi hedh sot shortin për 9 anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, (KED). Ata do të zëvendësojnë anëtarët e Këshillit të Përkohshëm të Emërimeve në Drejtësi. Ata janë 2 nga Gjykata Kushtetuese, 1 nga Gjykata e Lartë, 1 nga Prokuroria e Përgjithshme, 2 gjyqtarë dhe 2 prokurorë nga Apeli dhe 1 gjyqtar nga Gjykata Administrative.



Ish-kryeministri italian Romano Prodi dje në konferencën "Roli i ndërkombëtarëve në Itrançionin e Shqipërisë"

### LISTA E KANDIDATEVE QE PLOTESOJNE KRITERET PER ANETARET E KED

<b>Lista e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi</b>	<b>27-Valdete Hoxha</b> <b>28-Zejnine Sollaku</b> <b>Gjyqtarët e Apelit Durrës</b> 1-Agim Ferizaj 2-Anita Mici 3-Arben Vrioni 4-Arjan Balliu 5-Besim Treshnjeva 6-Desart Avdulaj 7-Izet Dushaj 8-Kilton Spahiu 9-Petraq Dhimitri 10-Petraq Ceno (kryetar) 11-Tritan Hamitaj 12-Valbon Cekrezi <b>Gjyqtarët e Apelit Gjirokastër</b> 1-Dritan Banushi (kryetar) 2-Enton Dhimitri 3-Irena Brahimi 4-Izet Salaj 5-Miranda Andoni 6-Tomor Shkreli <b>Gjyqtarët e Apelit Korçë</b> 1-Brunilda Orhani 2-Entela Priti (kryetare) 3-Etleva Temo 4-Olsi Xhevella 5-Sotiraj Lubonja 6-Stavri Kallço <b>Gjyqtarët e Apelit Shkodër</b> 1-Aleks Nikolli 2-Astrit Kalaja 3-Fuat Verdha (kryetar) 4-Hajrije Muçmata 5-Lindita Hoxha 6-Luan Dervishi 7-Marina Raboshta 8-Selim Kryeziu 9-Valbona Vata 10-Vojzava Osmanaj <b>Gjykata e Apelit Vlorë</b> 1-Alma Liçaj (kryetare)	<b>2-Brikena Ukperaj Lubonja</b> 3-Hysen Saliko 4-Iliba Bezati 5-Klodiana Gjyzari 6-Margarita Buhali 7-Nazmi Troka 8-Petrit Aliaj 9-Skënder Damini 10-Sokol Ngresi <b>Gjyqtarët e Apelit për Krimet e Rënda</b> 1-Albana Boksi 2-Dhimitër Lara 3-Dhurata Haveri 4-Fehmi Petku (kryetar) 5-Gurali Brahimllari 6-Gjovalin Pernocia 7-Idriz Mulikurti 8-Nertina Kosova 9-Nure Dreni 10-Saida Dollani 11-Sokol Binaj <b>Gjyqtarët e Gjykatës Administrative të Apelit</b> 1-Alkelina Gazidede 2-Altina Nasufi 3-Amarildo Laçi 4-Arjan Qafa 5-Artur Malaj 6-Bari Shyti 7-Bernina Kondi 8-Blerona Hasa 9-Enkelejda Softa 10-Fjoralba Priti 11-Kastriot Selita (kryetar) 12-Lindita Sinanaj 13-Rilinda Selimi <b>Gjyqtarët e Gjykatës Administrative Durrës</b> 1-Eryg Gashi 2-Klodiana Mema Veizi 3-Marjana Verçani (kryetare)	<b>4-Gjyqtarët e Gjykatës Administrative Gjirokastër</b> 5-Elidon Papaziti 6-Ramiz Lala(kryetar) <b>Gjyqtarët e Gjykatës Administrative Korçë</b> 1-Etleva Gjamo 2-Sokol Ibi (kryetar) <b>Gjyqtarët e Gjykatës Administrative Shkodër</b> 1-Ahmet Janullit 2-Valbona Durraj Seknaj <b>Gjyqtarët e Gjykatës Administrative Vlorë</b> 1-Astrit Shema (kryetar) 2-Gentian Xhelli 3-Ken Dhima 4-Bervis Shehaj <b>Gjyqtarët e Gjykatës Administrative Tiranë</b> 1-Afërdita Maho 2-Arbena Ahmeti 3-Avni Sejdi 4-Bezart Kaçani 5-Elda Vrioni 6-Etleva Çiçolli 7-Emiliano Ruli 8-Energjeta Shehaj Deraj 9-Erardër Madhi 10-Eriol Roshi (kryetar) 11-Gentian Hamiti 12-Gentian Medja 13-Gentjana Muçaj 14-Nafije Curri Hasko 15-Selvjë Gjoçaj 16-Semiramis Hoxholli <b>Lista me emrat e prokurorëve për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi</b> 1-Rovena Gashi 2-Gentian Trenova 3-Fatjona Memçaj
---	--	--	---

Drejtësisë". Në letërën për kryetarin e Kuvendit, që i drejtohet edhe presidentit, institucioneve të përfshira në proces dhe ambasadorëve, theksohet se: "Qëllimi të kësaj së drejtësisë i shërben edhe mungesa e plotë e transparencës. Kuvendi nuk ka

bërë publik, si herën e shkuar, korrespondencën me Presidentin e Republikës dhe institucionet e pavarura, si dhe nuk keni publikuar apo njoftuar listën e kandidatëve që do të përfshihen në short. "Konkluzioni i dytë është se procesi i nisur

nga Kryetari i Kuvendit po kryhet në boshllëk kushtetues dhe ligjor, sepse në mungesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP), po përdoret dispozita tranzitore, që kanë humbur fuqinë e

tyre. KED e Përkohshme u zgjodh në janar 2017 sipas dispozitës kalimtare dhe kjo dispozitë nuk mund të bëhet rregull i përgjithshëm".  
**LSI**  
Pas PD-së, edhe LSI kundërshtoi shortin për 9 anëtarët e Këshillit të Emëri-

meve në Drejtësi, (KED). Kreu i grupit parlamentar të LSI, Petrit Vasili i dërgoi një letër kreut të Kuvendit, Gramoz Ruçi sipas të cilit procesi është i pavlefshëm ligjërisht, pasi duhet të bazohet në kriteret ligjore. "Grupi parlamentar i LSI nuk mund të bëhet pjesë e procesi përzgjedhës të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, i cili po zhvillohet me procedura aspak ligjore dhe bazuar në kriteret, të cilat janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.115/2016 'për organet e qeverisjes në sistemin e drejtësisë'. Sipas LSI, ky proces bazohet në kandidatura që janë siguruar nga institucione që ligji nuk ia njeh të drejtën për t'i përzgjedhur dhe askush përveç ligjit nuk mund t'ua ngarkojë këtë detyrë. Ky proces po ndërtohet bazuar në urdhra dhe vullnetin e kryetarit të Kuvendit, ndërkohë që Kushtetuta dikton se kriteret përcaktohen në ligj. Nuk ekziston asnjë dispozitë ligjore dhe kushtetuese që zgjidh situatën e krijuar në mungesë të institucioneve të KLGJ dhe KLP. Kriteret kualifikuese të kandidatëve që pretendohet të marrin pjesë në short për zgjedhjen e KED-së nuk janë kriteret që kërkon ligji nr.115/2016, neni 221. Kandidatëve që nuk përfshihen në listën për short u është mohuar faktikisht e drejta për t'u ankuar. Për këto arsye e shumë të tjera, i gjithë procesi jo vetëm që është një proces 'nul' dhe antikushtetues, por e gjithë veprimtaria e kujtudo në lidhje me të është e dënueshme moralisht nga populli, por edhe ligjërisht nga Kodi Penal".



Ish-kryeministri italian: Procesi i integritimit në BE i ngadaltë

# Reformat dhe droga, Romano Prodi: Duhet reagim i brendshëm shumë i fortë

Takimi, Meta i propozon të ndërtojë një simbol të turizmit

Darina Tanushi

Ish-kryeministri italian Romano Prodi, i njohur si një nga miqtë e Shqipërisë u shpreh dje, se "Procesi i integritimit në BE është ende shumë i ngadaltë dhe duhet të përshpejtohet". Ndërsa i pyetur nga gazetaret për drogën ai tha: "Reformat dhe problemet e drogës janë të rënda dhe serioze, por ka nevojë për një reagim të brendshëm shumë të fortë". Prodi ishte i ftuar në konferencën "Roli i ndërkombëtarëve në tranzicionin e Shqipërisë", që u zhvillua dje, sot në Tiranë nga Prezenca e OSBE-së si pjesë e veprimtarive për 20-vjetorin e saj në Shqipëri. Prodi u takua dje, para konferencës edhe me Presidentin e Shqipërisë, Ilir Meta. Kreu i shtetit shqiptar ka vlerësuar propozimin e Prodit për të ndërtuar një simbol të turizmit. "Një mëngjes pune me mikun e shqiptarëve, profesor Romano Prodin, me të cilin diskutuam për marrëdhëniet e shkëlqyera mes dy vendeve tona të ardhmen europiane të Shqipërisë. I drejtë propozimi i mikut tonë për të ndërtuar një simbol të turizmit shqiptar, që do promovonte edhe më fuqishëm rritjen cilësore të turizmit e përfitimëve", shkroi Ilir Meta në "Facebook". Ndërkohë gjatë fjalës që Prodi mbajti në këtë konferencë u shpreh: "Një pikë e rëndësishme janë reformat e bëra, të cilat duhet zbatuar me përpikëri. Është i dukshëm ndryshimi i përditshëm juaj. Me prioritet është zbatimi i reformës në drejtësi, reformimi i sistemit të drejtësisë, lufta ndaj krimit e korrupsionit. Gjithçka duhet bërë me shpejtësinë më të madhe të mundshme, është momenti për të vepruar. Edhe ne duhet të hidhemi në aksion për të përmbushur atë që ka mbetur". Me tej, ish-kryeministri i Italisë, Romano Prodi, ka vlerësuar progresin e Shqipërisë në rrugën drejt Bashkimit Evropian, duke thënë se është mjaftueshëm i dukshëm. Ish-kryeministri italian tha se rrjedhat në vendin tonë kanë qenë të jashtëzakonshme, por edhe ndryshimet të mëdha, të cilat i kanë ndryshuar plotësisht fytyrën Shqipërisë. Me tej, ai shtoi se



Ish-kryeministri italian Romano Prodi me Presidentin e Shqipërisë, Ilir Meta

**ROMANO PRODI**

"Reformat dhe problemet e drogës janë të rënda dhe serioze, por ka nevojë për një reagim të brendshëm shumë të fortë. Bashkëpunimi ndërkombëtar kundër kriminalitetit është një nga kapitujt e mëdhenj që duhet çuar përpara. Është përmirësuar shumë, por ende nuk është e mjaftueshme. Procesi i integritimit në Bashkimin Europian është ende shumë i ngadaltë dhe duhet të përshpejtohet", -tha Prodi.

**AMBASADORI AUSTRIAK**

Ambasadori austriak, Johan Sattler, huazoi dy shprehje shqip për të treguar ndërrimin e rolit të të huajve në vendin tonë, dhe përgjegjësinë që kanë vetë shqiptarët për të ndërtuar vendin e tyre. "Nuk bëhet Shqipëria me shqiptarë", tha ai. Por, - shtoi Sattler, - Faik Konica ishte gabim, pasi Shqipëria do të bëhet me shqiptarët pasi i zoti e nxjerr gomarin nga balta, siç tha ai.



Kryetarja e LSI-së, takime në DAT

## Kryemadhi: Duhet një politikë e re në bashkëpunimin ekonomik me SHBA

Gjatë vizitës së saj në Washington, kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi u takua në Departamentin Amerikan të Tregtisë, me Ndihmës Sekretarin e Tregtisë për Menaxhimin e Eksportit Z. Richard Ashooh. Ndihmës Sekretari Ashooh konfirmoi gatishmërinë e plotë për të mbështetur Shqipërinë në çështjet e sigurisë industriale dhe të eksporteve të teknologjisë. Gjithashtu, Ndihmës Sekretari Ashooh shprehu interesin për të asistuar Shqipërinë gjërësisht në hartimin e legjislacionit, akteve rregullatore dhe metodave të monitorimit, dhe partneritetit reciprok për çështje që lidhen me industrinë dhe sigurinë industriale. Kryemadhi konstatoi se duhet një politikë e re në bashkëpunimin ekonomik me SHBA që t'i përshatet më mirë zhvillimit aktual të ekonomisë së Shqipërisë dhe hapjes gjithmonë më të madhe të saj ndaj biznesit amerikan. Kryemadhi zhvilloi një takim me znj. Sarah Kemp, zv. drejtoresha e Përgjithshme e Drejtorisë për Investime Ndërkombëtare. Kryetarja e LSI nënvizoi se pa një prani që rritet dukshëm të investimeve amerikane nuk mund të kemi atë zhvillim ekonomik për të cilin Shqipëria ka aq shumë nevojë dhe që është i lidhur drejtpërdrejtë me punësimin.

**Ministri i Brendshëm në Bruksel, takon Komisionerin për Migrimin**

## Avramopoulos: Të punojmë për të hapur dyert e Shqipërisë drejt BE

Ministri i Brendshëm Fatmir Xhafaj dje, në Bruksel Komisionerin për Migrimin, Punët e Brendshme dhe Shtetësinë, Dimitris Avramopoulos, i cili garanto mbështetjen për procesin e integritimit në BE. Pas takimit, Komisioneri Avramopoulos tha se "Shqipëria është një faktor i rëndësishëm stabiliteti për mbarë rajonin. Një fqinj i mirë i vendit nga i cili unë vij dhe, në të ardhmen, anëtar i familjes europiane". "Ndodhemi sot këtu për të punuar së bashku, në mënyrë që të kapërcejmë të gjitha çështjet dhe kërkesat që kërkojnë për t'i hapur Shqipërisë dyert drejt Bashkimit Evropian. Dhe ne jemi shumë të angazhuar të rrisim dhe thellojmë bashkëpunimin tonë, në mënyrë që të arrijmë këtë moment", -tha Avramopoulos. Nga ana e tij, ministri i brendshëm Fat-



Ministri i Brendshëm Fatmir Xhafaj dje, në Bruksel me Komisionerin për Migrimin, Punët e Brendshme dhe Shtetësinë, Dimitris Avramopoulos

**BASHKËPUNIMI**

"Ne jemi shumë të angazhuar të rrisim dhe thellojmë bashkëpunimin tonë, në mënyrë që të arrijmë këtë moment", -tha Avramopoulos.

mir Xhafaj tha: "Unë shpresoj dhe besoj që nën kujdesin e tij, me mbështetjen e tij, ne do të bëjmë hapa të rëndësishëm që kanë të bëjnë me çështjet e luftës ndaj krimit të organizuar, trajtimin të çështjeve të emigracionit të paligjshëm dhe një sërë çështjesh të tjera që na preokupojnë në rrugën tonë në integritimin në Bashkimin Evropian". Xhafaj e ftoi Komisionerin të vizitojë Shqipërinë për të parë përparimin e bërë, ftesë të cilën Komisioneri Avramopoulos e pranoi.

përtej rrjedhës politike, ka dhe disa kushte të tjera që duhen plotësuar për integritimin, për të cilin ish-kryeministri italian shtoi se Shqipëria duhet ndihmuar. "Progresi i këtij vendi është mjaftueshëm i dukshëm. Sfi-

da e Shqipërisë është lufta ndaj korrupsionit. Ka pritsmëri për një panoramë të re, pavarësisht tranzicionit", -tha Prodi. "Ne duhet ta ndihmojmë Shqipërinë në këtë proces", -u shpreh ai Prodi. Pas konferencës i pyetur nga

gazetarët, Prodi tha se problemet e drogës janë serioze dhe ka nevojë për reagim të brendshëm. Prodi, gjithashtu, nënvizoi nevojën e një bashkëpunimi më të mirë ndërkombëtar kundër këtij fenomeni.



Prokuroria: Zyrtarët, favorizuan grupin kriminal për transportimin e kanabisit drejt Ankonas

# 2.5 tonë drogë drejt Italisë, në pranga 7 persona

## Zbardhet skema, mes të arrestuarve 3 policë dhe 2 doganierë

Ina Allkanjari

2.5

Kalimi i kamionit me 2.5 tonë drogë në janar të këtij viti nga porti i Durrësit drejt Italisë ka çuar në pranga 7 persona, mes të cilëve tre punonjës policie, një doganier dhe një agjent doganor. Pas arrestimit të nënkomisarisit të policisë së Fierit, Festim Lelaj, me urdhër të Prokurorisë për Krime të Rënda u ndaluan ditën e djeshme dy efektive të drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit në Durrës Gëzim Dervishi dhe Agron Kapllani. Gjithashtu, të dyshuar për bashkëpunim me këtë grup, janë dhe doganieri Altin Katundi dhe agjenti doganor Mikail Hila, të cilët janë vënë nën arrest. Sipas prokurorisë, zyrtarët kanë favorizuar grupin kriminal për transportimin e sasisë prej 2.5 tonë drogë drejt Ankonas në janar të këtij viti. Sakaq Policia e Shtetit, në koordinim me zyrën ndërlidhëse të policisë italiane "Interforza" në Tiranë, ka zbardhur dinamiken e plotë të ngjarjes ku u lejua kalimi i 2.5 tonë drogë nga porti i Durrësit.

### TË ARRESTUARIT

Policia e Shtetit jep detaje për grupin e të arrestuarve, të cilët dyshohet se lejuan kalimin e një kamioni me 2.5 tonë drogë në Ankona, Itali. Behet me dije se më datë 13.01.2017 nga ana e Zyrës Ndërlidhëse të Policisë Italiane "INTERFORZA" në Tiranë, është informuar Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, mbi sekuestrimin e një sasisë prej 2 tonë e 530 kg lëndë e dys-

### TONË DROGË

Kalimi i kamionit me 2.5 tonë drogë në janar të këtij viti nga porti i Durrësit në Ankona, Itali, ka çuar në pranga 7 persona, mes të cilëve tre punonjës policie, një doganier dhe një agjent doganor.

huar e llojit "Cannabis Sativa" me datë 11.01.2017 në portin e Ankonas në Itali. Kjo sasi ishte e ngarkuar në kamionin "MAN", me targa AA 846 GJ dhe AER 357, me drejtues shtetasin shqiptar Dhimo Koraj, 47 vjeç, lindur në Fier e banues në Gjirokastrë.

Mësohet se ky kamion më datë 09.01.2017 është nisur nga porti i Durrësit me tragetin M/N AF MARINA me destinacion Durrës-Bari. Policia italiane ka arrestuar në flagrancë shtetasin shqiptar Dhimo Koraj, i cili shoqëronte kamionin në Portin e Ankonas, ndërsa në listën e pasagjerëve figuronte si shofer i këtij kamioni i nisur nga Durrësi më datë 09.01.2017, shtetasi Demo Progonati, 46 vjeç, lindur në Progonat dhe banues në Fier. Në bazë të informacionit të sjellë nga pala italiane, Drejtoria për Hetimin e Narkotikëve dhe Trafiqeve në Policinë e Shtetit ka bërë regjistrimin e procedimit penal Nr.12, datë 13.01.2017 në Prokurorinë e Krimeve të Rënda dhe në vazhdim e ve-



Droga e sekuestruar në kamion

### ARRESTIMET

- **Skënder Siqeca**, 53 vjeç banues në Vlorë, për veprën penale "Trafikimi i narkotikëve" e kryer në bashkëpunim.
- **Arbi Mustafa**, 34 vjeç, banues në Vlorë, për veprën penale "Trafikimi i narkotikëve" e kryer në bashkëpunim.
- **Agron Kapllani**, 51 vjeç, banues në Durrës, ish-punonjës policie, trup shërbimi, shoqërues qeni në Portin e Durrësit, për veprën penale të "Trafikimi i narkotikëve" kryer në bashkëpunim.
- **Gëzim Dervishi**, 59 vjeç, banues në Durrës, ish-specialist në trajtimin e

- qenve të shërbimit në Stacionin e Policisë Kufitare Durrës, në për veprën penale të "Trafikimi i narkotikëve", kryer në bashkëpunim.
- **Festim Lelaj**, 47 vjeç, Specialist për Hetimin e Krimeve në Komisaratin e Policisë Fier.
- **Altin Katundi**, 50 vjeç, lindur e banues në Tiranë, me detyrë doganier në Portin e Durrësit.
- **Mikail Hila**, 28 vjeç, banues në Tiranë, për kryerjen e veprës penale "Trafikimi i narkotikëve", e kryer në bashkëpunim.

primeve hetimore të kryera nga Policia e Shtetit nën drejtimin e Prokurorisë së Krimeve të Rënda, deri me tani janë arrestuar në kuadër të këtij procedimi 7 shtetas. Konkretisht më datë 04.12.2017, u ndaluan shtetasit Skënder Siqeca, 53 vjeç

dhe Arbi Mustafa, 34 vjeç, banues në Vlorë, për veprën penale "Trafikimi i narkotikëve e kryer në bashkëpunim"; më datë 05.12.2017, u ndalua shtetasi Agron Kapllani, 51 vjeç, banues në Durrës, ish-punonjës policie, trup shërbimi, sho-

qërues qeni në Portin e Durrësit, për veprën penale të "Trafikimi i narkotikëve", kryer në bashkëpunim; më datë 05.12.2017, u ndalua shtetasi Gëzim Dervishi, 59 vjeç, banues në Durrës, ish-specialist në trajtimin e qenve të shërbimit në Stacio-

nin e Policisë Kufitare Durrës, në për veprën penale të "Trafikimi i narkotikëve", kryer në bashkëpunim; më datë 05.12.2017, u ndalua nga SH.Ç.B.A, shtetasi Festim Lelaj, 47 vjeç, specialist për Hetimin e Krimeve në Komisaratin e Policisë Fier; më datë 06.12.2017, u ndalua shtetasi Altin Katundi, 50 vjeç, lindur e banues në Tiranë, me detyrë doganier në portin e Durrësit; më datë 06.12.2017, u ndalua shtetasi në kërkim Mikail Hila, 28 vjeç, banues në Tiranë, për kryerjen e veprës penale "Trafikimi i narkotikëve", e kryer në bashkëpunim. Po në kuadër të këtij procedimi janë arrestuar më parë edhe 4 shtetas të tjerë. Konkretisht më datë 15.01.2017, u ndalua shtetasi në kërkim Euron Hoti, 35 vjeç, banues në Lezhë, për veprën penale "Trafikimi i narkotikëve"; më datë 21.06.2017, u ndalua shtetasi Malton Lleshi, 34 vjeç, banues në Tiranë, për veprën penale "Trafikimi i narkotikëve e kryer në bashkëpunim"; më datë 28.11.2017, u ndalua shtetasi në kërkim Aurel Lazaj, 32 vjeç, banues në Vlorë. Në lidhje me këtë rast trafiku të lëndëve narkotike, Drejtoria për Hetimin e Narkotikëve dhe Trafiqeve në Policinë e Shtetit nën drejtimin e Prokurorisë për Krime të Rënda vijojnë hetimet për zbardhjen dhe dokumentimin e plotë, duke çuar para drejtësisë të gjithë personat e implikuar.

## Policia: Në bagazhin e automjetit, u gjenden thasë të mbushur me drogë

### Kapen me 65.6 kg kanabis, arrestohen në flagrancë 3 persona, një shpallet në kërkim

**TIRANË** - Policia e Tiranës ka vënë në pranga tre persona dhe një tjetër është shpallur në kërkim, në një operacion antidrogë ku u sekuestruan 65.6 kg kanabis. Seksioni për Hetimin e Narkotikëve në Drejtorinë Vendore të policisë Tiranë, në vijim të punës për parandalimin dhe goditjen e prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike, kanë finalizuar me sukses operacionin "Vakumona". Gjatë këtij operacioni u arrestuan në flagrancë shtetasit shtetasit

### ARRESTIMET

Gjatë operacionit policor të koduar "Vakumona" u arrestuan në flagrancë shtetasit Bashkim Joca, 46 vjeç, banues në fshatin Shëngjergj; Albi Joca, 19 vjeç si dhe Mirel Joca, 18 vjeç, të tre personat banues në fshatin Shëngjergj, Vakumonë, Tiranë.

Bashkim Joca, 46 vjeç, banues në fshatin Shëngjergj; Albi Joca, 19 vjeç si dhe Mirel Joca, 18 vjeç, të tre personat banues në fshatin Shëngjergj, Vakumonë, Tiranë. Gjithashtu, në kuadër të këtij operacioni është shpallur në

kërkim shtetasi PL. Personat e sipërpërmendur u kapën në flagrancë më datë 05.12.2017, rreth orës 20:00, tek vendi i quajtur "Gurorja e Kllojkës". Gjatë operacionit në drejtim të goditjes së veprimtarisë së kundërlidhshme



Droga e sekuestruar

në fushën e narkotikëve, ka rezultuar se shtetasit Bashkim Joca, Albi Joca dhe Mirel Joca në bashkëpunim me njëri-tjetrin, kryenin aktivitetin e kundërlidhshëm të shitjes së lëndëve narkotike të dyshuar të llojit "Cannabis

Sativa" në sasi të konsiderueshme, personave të ndryshëm në zonën e Saukut, Berzhitës, Kllojkës, etj. Këto shtetas lëviznin me automjetin, "Renault Laguna", me targë AA 232 FI. Në vendin e quajtur "Gurorja e Kllojkës",

janë neutralizuar dhe prangosur të tre personat e lartpërmendur. Gjatë kontrollit nga forcat policore në bagazhin e automjetit të tyre janë gjetur dhe sekuestruar disa thasë të zin dhe të bardhë të mbushur me material bimor të thatë ngjyrë jeshile e dyshuar si lëndë narkotike e llojit "Cannabis Sativa". Sasia e bimës së dyshuar si narkotike rezultoi në peshën totale 65.6 kg. Gjithashtu janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale 1 automjet dhe 4 telefona celularë. Materialet procedurale do t'i kalojnë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për veprime të mëtejshme hetimore, për veprat penale "Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike në bashkëpunim" në ngarkim të shtetasve Bashkim Joca, Albi Joca dhe Mirel Joca.

Aplikonin për punësim e studime në Kanada, gjobitet me 3.3 mln lekë shoqëria "Ande Lm shpk"

# Mashtrimi me vizat, gjykata dënon me 10 vite burg nënë e bijë

## Prokuroria: Lule dhe Adeila Makashi zhvatën 360 aplikantë

Ina Allkanjari

Gjykata e Tiranës ka shpallur vendimin për shtetaset Lule dhe Adeila Makashi, nënë e bijë, të cilat akuzohen se kanë mashtruar qytetarët me vizat e punësimit në Kanada. Gjykata ka dënuar me 9 vjet burg Lule Makashin, që nga gjykimi i shkurtuar shkon në 6 vjet. Ndërsa janë dhënë 6 vitet burg për të bijën, Adeila, e cila me gjykim të shkurtuar do të vuajë 4 vjet. Gjithashtu, është gjobitur me 5 milionë lekë shoqëria "Ande Lm shpk", ku edhe në këtë rast me gjykim të shkurtuar gjoba kap vlerën e 3.3 milionë leke. Më herët Prokuroria e Tiranës ka kërkuar dënimin me 18 vite burg në total për Lule Makashin dhe vajzës së saj, Adeila Makashi, pasi kanë mashtruar qytetarët me vizat e punësimit në Kanada. Përkatesisht 10 vite burg për të pandehurën Lule Makashu dhe 8 vite burg për të bijën.

**DËNIMI**

Gjykata ka dënuar me 9 vite burg Lule Makashin, që nga gjykimi i shkurtuar shkon në 6 vite. Ndërsa janë dhënë 6 vitet burg për të bijën, Adeila, e cila me gjykim të shkurtuar do të vuajë 4 vite. Gjithashtu është gjobitur me 5 milionë lekë shoqëria "Ande Lm shpk", ku edhe në këtë rast, me gjykim të shkurtuar gjoba kap vlerën e 3.3 milionë lekë.



Lule dhe Adeila Makashi



Ata kanë shpjeguar se kanë aplikuar në vitin 2014, për punësim dhe studime pranë shoqërisë "Ande-Lm" me administratore shtetasen L. M., që ndodhet me seli në rrugën "Ismail Qemali" Tiranë. Personat që aplikonin, pasi dorëzonin dokumentet që kërkonte kjo shoqëri, ishin në pritje për të dalë viza dhe shtetasja L.M. ka organizuar dhe takime të ndryshme në hotel me persona që janë prezantuar si avokatë kanadezë, duke shpjeguar dhe procedurat e marrjes së vizës së aplikantëve. Shtetasit që kanë aplikuar dhe kanë dorëzuar dokumentet për pajisjen me vizë, kanë paguar në llogari të shoqërisë "Ande-Lm" Sh.P.K. shuma të konsiderueshme në lekë dhe valutë. Pasi kanë shkruar në datë 25.04.2016 pranë zyrave të kësaj shoqërie, kanë mësuar se shtetasja L.M., së bashku me vajzën e saj ishin larguar jashtë shtetit. Bëhet me dije se kjo shoqëri i ishte lënë në administrim shtetasit K.R..

Mësohet se 360 shqiptarë kanë paguar diku te 20 mijë dollarë për viza pune në shtetin kanadez, pa marrë asgjë në këmbim, të mashtruar nga dy të akuzuarat. Pas denoncimit të bërë nga 26 persona në qytete të ndryshme të vendit, Seksioni për Krimin Ekonomik-Financiar në Policinë e Tiranës zbardhi një skemë mashtrimi. Policia shqiptare njoftoi au-

toritetet kanadeze për shpalljen në kërkim të Lule Makashit dhe vajzës së saj, pas arrestimit të bashkëpunëtorit të tyre, Klevis Rreshka. Më tej, autoritetet kanadeze bënë anulimin e vizave për këto dy shtetase, për t'i rikthyer në Shqipëri. Në momentin që nënë e bijë kanë mbërritur në tokën shqiptare, janë transportuar në Drejtorinë Vendore të Poli-

cisë Tiranë, ku janë marrë në pyetje nga oficerët veçmas nga njëra-tjetra. Mësohet se dy të pandehurat dhe bashkëpunëtorit i tyre, Klevis Rreshka, u kanë premtuar personave të ndryshëm se do t'u siguronin dokumente punësimi dhe studimi për në Kanada, Australi, Angli e në disa vende të ndryshme jashtë shtetit, kundrejt shumave të konsiderueshme

parash, të cilat varionin nga 2500 euro deri në 20 mijë euro (në disa raste edhe me dollarë). **DOSJA E PROKURORISE** Nga studimi i të dhënave të dokumentuara nga Policia Gjyqësore dhe verifikimet e bëra rezultoi se në datën 25.04.2016 në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë janë paraqitur dhe kanë bërë kallëzim 26 shtetas.



**Aplikim për të përfituar Statusin e Naftëtarit**

Njoftohen të gjithë punonjësit dhe ish-punonjësit e shoqërisë Albpetrol sh.a se, bazuar në Ligjin Nr.8/2017 "Për Statusin e Punonjësve të Industrisë së Naftës dhe Gazit" dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.425 datë 10.05.2017, se ka filluar shpërndarja e dokumenteve për Statusin e Naftëtarit. Personat e interesuar që të pajisen me dokumentet përkatëse duhet të paraqiten pranë njëres prej qendrave të punës ku kanë punuar dhe të fillojnë procedurën.

Shoqëria Albpetrol sh.a sqaron të gjithë personat e interesuar se disponon dokumentacion për periudhën që kanë punuar në shoqërinë Albpetrol sh.a nga viti 1994 e në vazhdim. Për periudhën përpara vitit 1994, dokumentet mund të merren pranë Sigurimeve Shoqërore ose arkivave të tjera.

Personat që duan të pajisen me vërtetim të posaçëm zyrtar për periudhën përkatëse duhet të plotësojnë formularin përkatës, i cili mund të shkarkohet në adresën [www.albpetrol.al/statusi-i-naftetarit/](http://www.albpetrol.al/statusi-i-naftetarit/) ose mund të tërhiqet fizikisht pranë qendrave ku kanë punuar.

Formulari i plotësuar duhet të dorëzohet në qendrat ku keni punuar së bashku me një kopje të librezës të punës ose mund të dërgohet me postë në qendrën përkatëse.

**Avokati mbrojtës: Papërgjegjshmëri nga organi i akuzës**

**Shtyhet seanca gjyqësore ndaj Emiljano Shullazit, shkak mungesa e prokurorëve**

Shtyhet seanca gjyqësore ndaj Emiljano Shullazit dhe bandës së tij, pasi nuk u paraqitën dy prokurorët e çështjes. Kjo mungesë solli reagimin e avokatëve mbrojtës, të cilët e cilësuan si papërgjegjshmëri mosparaqitjen e organit të akuzës. "Nuk është hera e parë që mungojnë prokurorët dhe kjo është jo vetëm shkelje ligji, por papërgjegjshmëri e njëherazi mungesë vullneti për të përfaqësuar akuzën në gjyq. Shteti s'mund të tallë me ligjet që ka miratuar vetë. Për këtë arsye kërkoj shuarjen e masës së sigurisë për klientin tim, Emiljano Shullazi", tha avokati Vladimir Meçe. Në të njëjtën linjë ishin edhe mbrojtësit e tjerë, dy prej të cilëve këmbëngulën në shuarjen e çështjes penale, pasi sipas tyre, vetëm atëherë prokuroria do të reagojë dhe do të tregohet më e përgjegjshme. Përmes një shkresë prokurorët informonin gjykatën se e kishin të pamundur për të qenë të pranishëm në seancë, pasi ndodhen jashtë vendit për arsye pune. Në



Emiljano Shullazi

**AVOKATI**

"Nuk është hera e parë që mungojnë prokurorët dhe kjo është jo vetëm shkelje ligji, por papërgjegjshmëri e njëherazi mungesë vullneti për të përfaqësuar akuzën në gjyq. Për këtë arsye kërkoj shuarjen e masës së sigurisë për klientin tim, Emiljano Shullazi", tha avokati Vladimir Meçe.

kushte të tilla, gjykata firmosi për shlyerjen e procesit ndaj pesë të akuzuarve për gjobëvënie, grup të strukturuar kriminal dhe vepra të tjera penale. Kryesuesi i trupës gjyqësore theksoi se do t'i drejtohen me shkresë drejtuesit të Prokurorisë për Krime të Rënda, që nëse në

të ardhmen paraqiten situata të tilla, të merren masa për zëvendësimin e përfaqësuesve të akuzës në gjyq. Në seancën e së mërkurës pritej të zhvilloheshin ballafaqimet mes biznesmenit të penduar Ylvi Begja me noteren Aida Spahiu dhe me dy shoferët e tij.





Foto ilustruese

## Dyshohen për lidhje me veprimtari terroriste, Italia dëbon dy shqiptarë

**ITALI** - Policia italiane ka dëbuar dy shqiptarë, pasi dyshohen se kanë pasur lidhje me veprimtari terroriste. Mediat italiane raportojnë se shqiptarët, identiteti i të cilëve nuk bëhet i ditur; rezidentë në Puglia, janë dëbuar për arsye sigurie kombëtare. "Ansa" shkruan se

sipas autoriteteve italiane, me dy rastet e fundit, numri i personave të dëbuar nga Italia, të konsideruar persona me lidhje ekstreme fetare, shkon në 232 nga 1 janari 2015 deri tani në 2017-ën. Kujtojmë se në muajin tetor autoritetet italiane dëbuan edhe dy persona, një shqiptar

dhe një shtetas maqedonas. Bëhej fjalë për një maqedonas 36-vjeçare dhe një 27-vjeçar shqiptar, banorë në provincën e Barit, që ishin monitoruar prej kohësh nga policia, pasi rezultoi që ata kishin marrëdhënie të ngushta shoqërore me disa marokenë pro-islamike.

Nëna e 32-vjeçarit: Jemi të tronditur, shteti të interesohet për fatin e tim biri

**ELBASAN**

**A**rrestimi në Turqi i Mariglen Debrovës nga Cërriku ka tronditur prindërit e tij. Nëna e 32-vjeçarit, Fatime Debrova dje u bëri apel strukturave të shtetit që të interesohen për fatin e djalit të saj që u prangos pak ditë më parë në Ankara së bashku me bashkëshorten e tij turke, Naxhije Debrova. Një ditë pas publikimit të lajmit për arrestimin e çiftit (prindër të një vajze 2 vjeçe), "News 24" dhe "Gazeta Shqiptare" kanë kontaktuar me nënën e 32-vjeçarit, e cila banon në lagjen "5 Maj" të qytetit të Elbasanit. E moshuara tha se janë shumë të shqetësuar në lidhje me të birin, për të cilin nuk kishin asnjë informacion që prej dy javësh. Përmes lotëve, Fatime Debrova deklaroi se lajmin për arrestimin e djalit ia konfirmuan edhe profesorët turq të Medresesë të Cërrikut. "Nuk e di arsyen se përse është arrestuar im bir. Ai nuk merrej me asnjë veprimtari të paligjshme", u shpreh nëna e Mariglen Debrovës. Gjithashtu, ajo tregoi se Maringleni ka mbaruar studimet në Egjipt, ku ka qëndruar për 4 vjet dhe se prej 2 vitesh banonte në Turqi me bashkëshorten turke, Naxhien me të cilën kanë një vajzë 2 vjeçe. Sipas Fatime Debrovës, nusen e djalit e kishin hequr nga puna (ish-te mësuese fizike) prej disa kohësh, ndërsa Maringlen kërkonte vazhdimisht punë.

**REAGIMI DHE APELI I NËNËS**

Fatime Debrova beson se djali i saj (sipas mediave turke u arrestua si bashkëpunëtor i Gylenit) është i pafajshëm. "Lajmin për arrestimin e tim biri dhe të gruas së tij e mësuam dy javë pasi kemi folur për herë të fundit me të. Na e tha një i njohuri ynë nga Cërriku. Fëmija e tyre, është tek gjyshërit nga nëna, sepse nusja është shtetase turke. Mediat thonë se djali dhe nusja janë arrestuar nën akuzën si bashkëpunëtor i Gylenit, por as që bëhet fjalë të jenë ngatërruar me gjëra të paligjshme. Ata janë të mrekullueshëm dhe shumë korrektë në jetën dhe punën e tyre"; - tha e dëshpëruar nëna e 32-vjeçarit. Po ashtu ajo tregoi se lajmin mbi ar-

# U arrestua si gylenist, Fatime Debrova: Djali s'merrej me gjëra të paligjshme

"S'e di nëse punonte në Turqi, do botonte një libër"



Mariglen Debrova me bashkëshorten turke



Fatime Debrova, duke folur për "GSH"



**AKUZA**

"Lajmin për arrestimin e tim biri dhe të gruas së tij e mësuam dy javë pasi kemi folur për herë të fundit me të. Na e tha një i njohuri ynë nga Cërriku. Fëmija e tyre, është tek gjyshërit nga nëna, sepse nusja është shtetase turke. Mediat thonë se djali dhe nusja janë arrestuar nën akuzën si bashkëpunëtor i Gylenit, por as që bëhet fjalë të jenë ngatërruar me gjëra të paligjshme. Ata janë të mrekullueshëm dhe shumë korrektë në jetën dhe punën e tyre"; - tha e dëshpëruar nëna e 32-vjeçarit.

mësuese, por e kanë hequr nga puna para disa kohësh. Donim të shkonim në Turqi, por nuk kemi mundësi financiare. Nuk dimë as ku dhe si të shkojmë", u shpreh Fatime Debrova. Ndërkaq ajo pohoi se kanë sakrifikuar shumë bashkë me të shoqin për shkolluar Maringlenin. "Nuk besoj asgjë na ato që thuhet për djalin. Ai bëri katër vite në Cërrik, pastaj vajti në Turqi, u martua, bëri dasmë, vajtëm dhe ne. Pastaj lindi dhe fëmijë, një vajzë. Djali ka mbaruar studimet për gjuhë të huaja, turqisht, arabisht, anglisht. Unë kam qenë vetëm për dasmën e tij në Turqi. Nuk ka ardhur fare në Shqipëri djalit", shtoi e moshuara. E ndërsa apeloi për ndihmë, nëna e Marigleni tha se dikush i ka shkuar në familje dhe i ka kërkuar 7 mijë euro për ta ndihmuar për të nxjerrë djalin nga burgu. "Unë jetoj vetëm me bashkëshortin dhe nuk kemi para. E vetmja mundësi është që të shesë shtëpinë dhe të ngelim mes katër rrugëve. I bëj thirrje shtetit që të na ndihmojë duke u interesuar për djalin", deklaroi e moshuara.

**KUSH ËSHTË MARGLEN DEBROVA**

Burime për "GSH" bënë me dije se 32-vjeçari Mariglen Debrova po vazhdonte doktoraturën për teologji në qytetin Samsun, pranë Ankarasë në Turqi. Pas kishte mbaruar 4 vjet kolegji në Cërrik, ai vijoi studimet për Teologji në Egjipt e më pas u transferua në Turqi. Ndërkohë, mësohet se Mariglen Debrova kishte dy vjet që nuk kishte ardhur në Shqipëri.

**SHKURT**

**Armë dhe drogë në përurra, në kërkim dy poseduesit**

**MEMALIAJ** - Efektivët e Drejtorisë së Policisë së Qarkut të Gjirokastrës kanë gjetur dhe sekuestruar kanabis dhe armë zjarri në fshatin Zhapokikë të Memsliajt. Pas informacioneve të siguruara në rrugë operative se dy persona (emrat e të cilëve nuk bëhen me dije për arsye hetimore, po transportonin armë e drogë në një përurra me qëllim fshehjen e tyre, policia ka ushtruar kontroll në vendin e quajtur "Përroi i Madh", në fshatin Zhapokikë. Gjatë kontrollit u gjetën të fshehura në një zone me shkurre 4 armë zjarri dhe dy krehër me fishekë si dhe 5 kg kanabis sativa në një qese të zezë. Blutë po punojnë për zbardhjen e plotë të kësaj veprimtarie kriminale si dhe për kapjen e autorëve.

**U gjenden 30 mijë euro në makinë,**

**2 persona nën hetim**

**SARANDË** - Policia e Sarandës ka referuar materialet në prokurorinë e këtij qyteti për pastrim parash, për dy persona, pasi iu është gjetur në makinë një shumë parash cash. Sipas burimeve zyrtare ka nisur hetimi për shtetasit Y.Q., 41 vjeç dhe E.S.H., 35 vjeç, banues në fshatin Shtar, Delvinë. Mësohet se gjatë kontrollit në mjet në fshatin Shtar iu gjetën e bllokuan në cilësinë e provës materiale rreth 30 mijë euro cash. Po punohet për sqarimin dhe dokumentimin e plotë ligjor të ngjarjes. Materialet janë referuar për Nenin 287 të Kodit Penal, "Pastrimi i produkteve të veprës penale".

**Plagosi vëllain se i rrahu gruan, në pranga të dy**

**ELBASAN** - Sherri mes dy vëllezërve ka bërë që të dy të përfundojnë në pranga, njëri prej tyre i plagosur. Burime nga policia bënë me dije se ngjarja ndodhi në lagjen "5 Maj" të qytetit të Elbasanit. Mësohet se në pranga kanë rënë Fatmir Bakalli, 56 vjeç dhe Shpendi Bakalli, 49 vjeç, ky i fundit u plagos me thikë. Sipas bluve Fatmir Bakalli u kap, pasi akuzohet se ka goditur me thikë vëllain (Shpendin) për motive të dobeta. Ndërsa, Shpendi Bakalli u prangos, pasi dyshohet të ketë dëmtuar derën e oborrit të vëllait, Fatmirit dhe ka ushtruar dhunë fizike ndaj bashkëshortes së të vëllait shtetasas M.B., 53 vjeçe, duke i shkakuar dëmtime fizike, e cila ndodhet jashtë rrezikut për jetën.


"Më mirë të ngelemi në rrugë se sa të jetojmë me një kriminel"

# Burri vrau biznesmenin te dera e shtëpisë, gruaja kërkon divorcin

## 28-vjeçarja Suzana Metuku: E bëj për fëmijët e mi

TIRANË

Një divorci i pazakontë është kërkuar 'live' në studion e emisionit "Me Zemër të Hapur" ditën e djeshme. 28-vjeçarja Suzana Metuku është nëna e tre djemve të vegjël dhe ka mbi 11 vite që po jeton në një tmerr të vërtetë në martesën me Olti Metukun, një i ri nga veriu i Shqipërisë, që aktualisht ndodhet në burg. Suzana ka qenë e shoqëruar në studio nga nëna e saj, Liria Haka, ndërsa ka rrëfyer arsyet pse po shkoi drejt ndarjes me babain e tre djemve të saj. Olti Metuku së bashku me dy vëllezërit e Suzanës, Admir dhe Herton Haka ndodhen në burg, pasi janë akuzuar për vrasjen e biznesmenit 45-vjeçar Fatmir Pula. Ngjarje kjo e ndodhur më 19 janar të vitit të kaluar. Edhe pse janë shpallur faj-



28-vjeçarja Suzana Metuku në emisionin "Me Zemër të Hapur"

torë, Liria beson se ka qenë dhëndri, që ka bërë pjesë të skenarit edhe dy djemtë e saj. Ndonëse drejtësia s'e ka dhënë fjalën e fundit, nëna e dy djemve tha se ata duhet të marrin dënimin që u takon. Por, dhe ajo erdhi që të kërkojë ndihmë ligjore dhe psikologjike për vajzën,

Suzanën dhe tre nipërit e saj. Babai i tyre ndodhet në burg, ndërsa Suzana jeton aktualisht në Kamëz tek vjehëri dhe vjehërra, të cilët kanë mësuar se ajo do ta divorcojë djalin e tyre, ndaj dhe i kanë vënë kusht që të largohet nga shtëpia me fëmijët. Ajo është e vetme dhe punon për të rri-

tur tre djemtë. "Divorci që do të bëj, do të na lërë mes katër rrugëve. Pa një strehë. Më mirë në rrugë se sa të jetojmë me një kriminel. Dua që fëmijët e mi të rriten dhe të edukohen ndryshe nga babai i tyre", tha në fjalën e saj 28-vjeçarja me lot në sy.



Shqiptari vdiq pasi u bllokua nga 5 policë në aeroportin e Malpensës, familja kërkon drejtësi

**ITALI** - Një 44-vjeçar shqiptar, i cili ndodhej në Itali për pushime ka humbur jetën në mënyrë tragjike, teksa po priste bashkëshorten në Terminalin 1 të aeroportit të Malpensës. Aldo Laci ishte nën efektin e kokainës, kur 5 oficerë policie e neutralizuan duke e shtrirë për tokë. Fatkeqësisht, në këtë moment ai shkroi jetë për shkak të një arresti kardial. Në një shkrim të botuar dhe nga e përditshma italiane "La Repubblica" thuhet se familjarët e 44-vjeçarit fajtojnë oficerët e policisë për vdekjen e njeriut të tyre dhe për këtë arsye kanë ngritur padi. Ata janë të bindur se pavarësisht gjendjes së tij nga efekti i drogës, vdekja ka ardhur drejtpërdrejtë, apo si pasojë e agresionit të ushtruar nga forcat e policisë. Sipas avokatit të familjes Laci, në pamjet e regjistruara nga kamerat e sigurisë së aeroportit, del qartë se 44-vjeçari u godit në kokë e më pas në qafë, u shtri për tokë e më pas u godit në mënyrë të përsëritur me grushte në trup e kraharor. Prokuroria e Busato Arsizio ka kërkuar arkivimin e kësaj çështjeje, pasi sipas saj, vdekja e shqiptarit nuk ka ardhur për shkak të dhunës së ushtruar nga një palë e tretë, ndërsa hetimet toksikologjike kanë provuar se viktima nuk ka qenë nën efektin e kokainës. Megjithatë, familja nuk ka ndërmend të dorëzohet dhe i ka kundërshtuar konkluzionet e prokurorisë.




**THIRRJE PËR PROJEKT-PROPOZIME**

Save the Children dhe Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara po zbatojnë projektin "Përfshirja e shoqërisë civile për një sistem drejtësi funksional dhe të barabartë për të gjithë në Shqipëri", financuar nga Bashkimi Evropian.

Projekti synon të kontribuojë në fuqizimin e shoqërisë civile, për të marrë pjesë aktivisht dhe të influencojë mirë-funksionimin e sistemit të drejtësisë në Shqipëri.

Fokusi i këtij projekti është të punojë me organizatat e shoqërisë civile të përfshira në monitorimin dhe aksesin në drejtësi, shoqata rinore dhe studentore, iniciativa qytetare, etj, ndër të cilat: 75 organizata që marrin pjesë në aktivitetet për rritjen e kapaciteteve të tyre, 34 organizata që përfitojnë grante, dhe 40 organizata që bëhen pjesë e Koalicionit.

Kjo thirrje për Projekt-Propozime, është e vlefshme prej datës **1 nëntor – 15 dhjetor 2017**, dhe i përket Skemës së Granteve, si një nga komponentët kryesorë të projektit, i cili ka si qëllim financimin e projekteve që adresojnë çështje të forcimit të organizatave të shoqërisë civile për të rritur transparencën dhe besueshmërinë e sistemit të drejtësisë dhe për të përmirësuar aksesin në drejtësi të grupeve të marxhinalizuara në Shqipëri.

Shuma në dispozicion për këtë Thirrje është EUR 435,000.00.

Buxheti i kërkuar për çdo Projekt-Propozim duhet të jetë si më poshtë:

Grante të vogla:	EUR 10,000.00 - 15,000.00	(deri në 12);
Grante të mesme:	EUR 20,000.00 - 25,000.00	(deri në 12).

Afati i fundit i dorëzimit të Projekt-Propozimeve është **15 dhjetor 2017, ora 14:00**.

Udhëzimet për mënyrën e aplikimit dhe dorëzimit të projekt-propozimeve, përshkruhen në Udhëzimin për Aplikim të Granteve, e cila mund të gjendet në internet, në:

<http://albania.savethechildren.net>  
<https://cefisaja.wordpress.com>

Një kopje e Udhëzimit të Aplikantit dhe formatit të aplikimit mund të kërkohej edhe duke dërguar një email në:

[cefisaja.albania@savethechildren.org](mailto:cefisaja.albania@savethechildren.org)  
[office@qshpli.org](mailto:office@qshpli.org)



**Njoftim i ALBtelecom Sh.a.**

**ALBtelecom njofton të gjithë abonentët e tij të telefonisë së lëvizshme se duke filluar nga data 15 dhjetor 2017:**

- Do të ofrojë dy paketa të reja 4 javore për të gjithë pajtimtarët me parapagesë:
  - Paketa Super 1300 do të përbëjë: 2,500 minuta të vlefshme drejt operatorëve kombëtarë; 2,500 minuta drejt ALBtelecom Fiks; 20 minuta ndërkombëtare; 250 SMS kombëtare/ndërkombëtare; 8 GB Internet; të përdorshme përkatësisht 5 GB me shpejtësi 3G/4G dhe 3 GB vetëm me shpejtësi 4G; si edhe ALBtv Mobile dhuratë; të vlefshme për 28 ditë; me çmim 1,300 Lekë (me TVSH).
  - Paketa Super 1900 do të përbëjë: 3,000 minuta të vlefshme drejt operatorëve kombëtarë; 3,000 minuta drejt ALBtelecom Fiks; 60 minuta ndërkombëtare; 300 SMS kombëtare/ndërkombëtare; 11 GB Internet; të përdorshme përkatësisht 8 GB me shpejtësi 3G/4G dhe 3 GB vetëm me shpejtësi 4G; si edhe ALBtv Mobile dhuratë; të vlefshme për 28 ditë; me çmim 1,900 Lekë (me TVSH). Abonentët të cilët e aktivizojnë këtë paketë përfitojnë paketën më të re të internetit EXTRA me 10 GB internet falas.
- Paketa ekzistuese 4 javore Super 1000 për numrat me parapagesë do të ndryshojë dhe njësitë e përfshira në këtë paketë do të jenë: 1,000 minuta drejt operatorëve kombëtarë; 1,000 minuta drejt ALBtelecom Fiks; 100 SMS kombëtare/ndërkombëtare; si edhe 6 GB Internet; të vlefshme në shpejtësitë 3G/4G; me vlefshmëri 28 ditore; me çmim 1,000 Lekë (me TVSH).
- Të gjithë pajtimtarët me parapagesë të cilët kanë të aktivizuar Paketën 1000 në momentin e ndryshimit, do të vazhdojnë ta përdorin këtë paketë të pandryshuar deri në përfundimin e afatit të vlefshmërisë së kësaj pakete.
- Paketat ekzistuese 4 javore Super 500-1 dhe Super 700 do të mbeten të pandryshuara.
- Paketat 4 javore Super 500-2, Super 1200, Super 1500 dhe Super 2000 nuk do të ofrohen më në treg. Të gjithë pajtimtarët me parapagesë të cilët kanë njërin prej këtyre paketave aktive në momentin e ndryshimit, do të vazhdojnë t'i përdorin ato deri në përfundimin e afatit të vlefshmërisë së tyre.

Për më shumë informacion vizitoni dyqanet tona ALBtelecom, faqen tonë zyrtare [www.albtelecom.al](http://www.albtelecom.al) ose telefononi Shërbimin e Klientit në 123.

## Bluzat e bardha të FA, kontroll në qarkun e Fierit Përmbytjet, Urgjenca Kombëtare, vizita mjekësore në shtëpitë e të prekurve

Pas përmbytjeve masive që prekën disa zona në mbarë vendin, ekipet e përcaktuara të mjekëve të Urgjencës Kombëtare Mjekësore kryen dje disa vizita për të mbajtur nën monitorim situatën shëndetësore të banorëve. Mjekët kryen ekzaminimet në disa qendra evakuimi në Fier e Vlorë, por edhe në shtëpitë e vetë familjeve të prekura nga përmbytjet. Këto vizita shtëpi më shtëpi u realizuan edhe në fshatin Bashkim, afër Vjosës, ku iu ofrua trajtim shëndetësor një gruaje të

### VIZITAT MJEKËSORE

Mjekët kryen ekzaminimet në disa qendra evakuimi në Fier e Vlorë, por edhe në shtëpitë e vetë familjeve të prekura nga përmbytjet. Këto vizita shtëpi më shtëpi u realizuan edhe në fshatin Bashkim, afër Vjosës, ku iu ofrua trajtim shëndetësor një gruaje të

posa operuar, e cila nuk kishte mundësi të shkonte për mjekim në spital. Më tej, në shkollën "Rakip Kryeziu" në Fier, në të cilën ka disa familje të evakuara nga Shën

Pjetri, në Njësinë Administrative Topojë, mjekët e Urgjencës Kombëtare kryen vizita mjekësore të të gjithë të evakuuarve dhe dërguan në spital një prej banorëve që

shfaqte probleme kardiace. Vizita nga mjekët e Urgjencës Kombëtare u kryen derë më derë edhe në Nosovelë, në fshatin Fitore, i cili rezultoi si një nga më të prekurit nga përmbytjet e ditëve të fundit. Ndërkaq, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ende po vijon monitorimin e situatës shëndetësore të banorëve të prekur nga përmbytjet me synim evitimin e një rritje të mundshme të sëmundshmërisë. Në ndihmë të banorëve të prekur nga përmbyt-



Urgjenca Kombëtare në shërbim të qytetarëve

ja në qarkun e Fierit kanë kontribuar edhe 13 mjekë dhe infermier të Forcave të Armatosura. Këta të fundit kanë qenë pranë familjeve të fshatit Ferras ku kanë kryer vizita specialiste me mjekë pneumolog, kardiolog, radiolog me ekografi, e mjekë të përgjithshëm. Përgjithësisht,

vizitat po realizohen në qendrën shëndetësore të kësaj njësie, me përjashtim të rasteve kur disa fëmijë apo të moshuar që nuk kanë mundësi të lëvizin, marrin ndihmën mjekësore në banesë. Medikamentet për të sëmurët po shpërndahen falas.

Mjeku Petrit Vargu: Pavijonet e tjera do marrin më shumë pacientë për të ulur fluksin

# Japin dorëheqjen edhe 4 mjekë të urgjencës së QSUT 7 specializantë kanë ikur në Gjermani

Voltiza Duro

Edhe 4 mjekë të tjerë të Urgjencës Qendrore në QSUT kanë firmosur ditën e djeshme letrën e dorëheqjes kolektive si pasojë e kushteve të rënda të punës. Burime konfidenciale nga urgjenca, bëjnë me dije për "Gazeta Shqiptare" se mjekët me iniciale L.Ç, P.P, B.H dhe R.P i janë bashkuar 8 kolegëve të tyre dhe janë solidarizuar në lidhje me këtë situatë. "I vetmi që nuk ka firmosur këtë peticion, është shefi i urgjencës, Edmond Zaimi, ndërkohë që jemi plot 12 mjekë që kemi firmosur dorëheqjen si pasojë e mbingarkesës dhe mosrespektimit të kontratës së punës. Në asnjë spital në botë nuk punohet në këto kushte ku punojmë ne", tregon një prej mjekëve të urgjencës për "GSH". Mjekët, nëpërmjet kësaj letrë drejtuar drejtorisë së QSUT, presidentit, kryeministrit e ministres së Shëndetësisë listojnë të gjitha arsyet që i kanë shtyrë të marrin një vendim të tillë. "Kushtet e punës së stafit mjekësor nuk plotësohen bazuar në kontratën punëdhënës-punëmarrës. Mbingarkesa me të sëmurët të shtuar që qëndrojnë mbi 48 orë në urgjencë për mungesë vendesh në pavijonet e tjera e moszbatimi i urdhrave të nxjerrë nga drejtorja, kemi marrë vendim që të tërhiqemi nga pozicioni ynë i punës, duke lajmëruar 30 ditë përpara", theksohet në letrën e dorëheqjes. Pavarësisht kësaj, të 12 mjekët e urgjencës, vazhdojnë të jenë në krye të detyrës e t'u shërbejnë radhës së gjatë të pacientëve. Gjithashtu, burimet konfidenciale bëjnë

### SPECIALIZANTËT

Të 12 mjekët e Urgjencës, vazhdojnë të jenë në krye të detyrës e t'u shërbejnë radhës së gjatë të pacientëve. Gjithashtu, burimet konfidenciale bëjnë me dije për "Gazeta Shqiptare", se 7 specializantë që kanë qenë pjesë e QSUT-së janë larguar në Gjermani për të ushtruar profesionin e tyre.

me dije për "Gazeta Shqiptare", se 7 specializantë që kanë qenë pjesë e QSUT-së janë larguar në Gjermani për të ushtruar profesionin e tyre. **RADHËT E GJATA** Në shërbimin e Urgjencës, dy ditë më parë, ishin hapur më shumë se 60 kartela për shtirë në Kardiologji, ndërkohë që në këtë pavijon numërohen vetëm 60 shtretër. Por pavarësisht kësaj, në një prononcim për "GSH" mjeku i urgjencës, Petrit Vargu tregon se situata paraqitet pak më e normalizuar. "Ju është caktuar shefave të pavijoneve të tjerë që të marrin rreth 7-8 pacientë në ditë, nga 2 që merrnin më parë me qëllim që të ulet fluksi në urgjencë. Pas peticionit, situata pak a shumë është normalizuar,



Situata në urgjencën e QSUT-së



### SITUATA

"Ju është caktuar shefave të pavijoneve të tjerë që të marrin rreth 7-8 pacientë në ditë, nga 2 që merrnin më parë me qëllim që të ulet fluksi në urgjencë. Pas peticionit, situata pak a shumë është normalizuar, pavarësisht se ngelet ende shumë për të bërë." - thotë Petrit Vargu.

pavarësisht se ngelet ende shumë për të bërë. Kjo është një neglizhencë totale dhe vetëm denonimi në media i bën të reflektojnë sado pak", thotë Vargu. Aktualisht, në Urgjencën Qendrore

Mjeku

të QSUT-së punojnë vetëm 12 mjekë, e kjo e bën të përballueshëm fluksin e pacientëve që dynden nga i gjithë vendi. "Ne kemi në dorë jetën e njerëzve, dhe mjekët nuk duhet të lodhen

### Ish-punonjësja: Asnjëherë nuk kam parë kaq fluks në dyert e Urgjencës

Ndërkaq një ish-punonjëse e urgjencës së QSUT-së, e ndodhur në urgjencë për një familjarin e saj, tregon për "Gazeta Shqiptare" se gjatë gjithë viteve të punës në këtë pavijon, nuk ka parë ndonjëherë një fluks të tillë pacientësh. "Unë kam qenë punonjëse në Urgjencën e QSUT-së për vite me radhë, por asnjëherë nuk ka pasur kaq shumë fluks pacientësh. Mjekët nuk kanë faj që po largohen, sepse realisht është e papërbalueshme nga ana e tyre. Aty korridorët janë të mbushura plot, nuk ka vend ku të ulen të sëmurët. E rrogat që marrin këta mjekë "heronj" janë të ulëta shumë e nuk e justifikojnë dot sakrificën e tyre", - thotë ish-punonjësja.

e të mbingarkohen së tepërmi pasi e gjithë kjo reflektohet te puna. Mund të gabojnë në diagnozë e në mjekimet që iu japin pacientëve", - thonë më tej burimet për "GSH".

### PREZANTIMI



Plani për qytetin e gjelbër, Veliaj: I domosdoshëm në rast përmbytjesh

Bashkia e Tiranës ka prezantuar ditën e djeshme planin e veprimit për qytetin e gjelbër, ku Tirana është një nga dy qytetet e përzgjedhura në Europë nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Synimi i këtij plani është të krijohet një qasje më të strukturuar ndaj problemeve kryesore mjedisore me të cilat përballlet kryeqyteti. Disa nga pikat kryesore të tij janë: lëvizshmëria e qëndrueshme, rritja e hapësirave të gjelbra, konsumi i qëndrueshëm i energjisë, përdorimi dhe trajtimi i qëndrueshëm i ujit etj. Kryebashkiaku Erion Veliaj gjatë prezantimit, theksoi se fatkeqësitë natyrore, përfshi këtu edhe rastin e shirave të ditëve të fundit, nxorën edhe një herë në pah nevojën për një plan të detajuar për transformimin e gjelbër të Tiranës. "Nga ky moment, në kalimë në një menaxhim totalisht profesional të situatës. Në dy vitet e para kemi kaluar fazën e emergjencave dhe shumë prej problematikave që kemi pasur në Tiranë, por tani nuk na falet më", - u shpreh Veliaj.

DPSHTRR: Detyrimet që fshihen, si të kryeni verifikimin nga targat

FSHIRJA E DETYRIMEVE

Subjektet që duan të mbajnë mjetin në qarkullim u fshihen detyrimet tatimore për periudhat dhjetor 2010 e më parë, me kusht që të paguajnë detyrimet për periudhën janar 2011 e në vijim, me përjashtim të gjobave për mospagesë së taksave të periudhës janar 2011 deri në dhjetor 2014, të cilat fshihen/shuhen me kushtin e pagesës së të gjitha detyrimeve të plota", thuhet në njoftim DPSHTRR.

Ornela Manjani

Drejtoria e Shërbimit të Transportit Rrugor ju kujton drejtuesve të mjeteve që kanë detyrime të pashlyera se kanë afat deri në 31 dhjetor për të përfunduar nga amnistia. Zbatimi i ligjit "Për pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/shuarjes së detyrimeve tatimore", ka hyrë në një fazë të rëndësishme. Kështu thotë në një njoftim të fundit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor, ku thekson se procedurat mund të

Amnistia për makinat, afati deri në 31 dhjetor

Janë 140 mijë automjete që përftojnë nga falja

ndiqni deri më datë 31 dhjetor 2017. "Brenda datës 31.12.2017, njoftohen të gjithë qytetarët që të përfundojnë nga procedura e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/

shuarjes së detyrimeve. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor ka publikuar dhe azhurnuar listën e mjeteve objekt i ligjit 33/2017, ku të gjithë personat e interesuar

mund të bëjnë verifikimin e targës dhe karakteristikave të tjera të mjetit në këtë listë. Subjektet / personat përgjegjës të paraqitjes pranë Drejtorive Rajonale të Shërbimeve të Transpor-

tit Rrugor për të kryer pa pagesë, veprimet e heqjes nga qarkullimi të mjetit apo për të kërkuar moskryerjen e procedurës së heqjes nga qarkullimi dhe mbajtjen aktiv të tij.

TARGAT E MJETEVE QË KANË DETYRIME TË PASHLYERA

Table with 10 columns of license plate numbers (TARGA) and corresponding vehicle identification numbers (VIN).

# KUJTIMET E BURGUT KOMUNIZMI

**EKSKLUZIVE** / Kujtimet e ish-të dënuarit politik Gëzim Çela, i cili vuajti për 23 vjet në burgjet e regjimit komunist

## Pse e përjetova me emocion në qeli, në '63-in, vrasjen e Presidentit, Kenedy Situata në Spaç, kishim të drejtë të qeshnim

Nga Gëzim Çela

Në Spaç, në sallën e mensës, ku gjithë ditën sipas plan eve bëhej leximi i materialeve të partisë dhe të shokut Enver, për riedukimin e të dënuarve, kishin sjellë një televizor, por e kishin mbyllur në një kafaz dërrase dhe kyçur me dry, të cilin e mbante polici, që e hapte në orën 18<sup>00</sup> dhe e mbyllte në orën 22<sup>00</sup>, kur bëhej pushimi.

Një natë shfaqej një film me Pitkinin dhe ne në sallë filluam të qeshnim me zë. Komanda u alarmua dhe urdhëroi policin dhe disa të tjerë që kishin ardhur për forcime që televizori të mbyllej dhe të dënuarit t'i nxirrnin jashtë nga salla. Të burgosurit nuk kishin të drejtë të qeshnin.

Në vitin 1962, kishim gati një vit që na kishin sjellë në Tiranë nga kampi i Thumanës, ku kishim punuar nëpër kanale për tharjen e kënetës, kurse këtu punonim për ndërtim banesash, afër ekspozitës "Shqipëria sot" (kështu quhej atëherë), në buzë të Lanës.

Një natë, një tufë policësh vërshuan nëpër kaponet ku flinim, na zgjuan me potere, duke bërtitur: "Cohuni!... Apeli!" Na rreshtuan dy e nga dy, të lidhur me tela dhe na detyruan të zbrisim poshtë, ku na prisnin disa autobusë. Ishte një shpikje e sigurimit, për të kamufluar lëvizjet e të burgosurve nga një kamp në tjetrin. Autobusët shoqëroheshin me ushtarë të armatosur. Autokolona mori drejtimin nga "21 dhjetori" dhe vazhdoi udhëtimin në errësi drejt Veriut.

Kur filloi të zbardhëllonte dita, kishim hyrë në Rubik, kaluam edhe urën dhe kthiyem djathtas bregut të lumit Mat. Pas disa kilometrash, ndaluan para një ndërtese dykatëshe që ishte e rrethuar me shtylla betoni të ngjizur një varg pa fund telash me gjemba dhe karakollë me ushtarë të armatosur; kudo ushtarë të armatosur, gati për të vrarë.


Kjo, pra, ishte ndërtesa - burg, e ngrehur për ne, ku do të fillonim që të nesërmen punën prej skllëverish për ndërtimin e uzinës së përpunimit të bakrit, ose siç është quajtur më vonë, fabrika e floririt...

Shpesh herë dëgjojmë nga ish-nomenklatura e partisë, që thonë dhe justifikohen:

"Kemi zbatuar ligjet e asaj kohe".

Atëherë, shtrohet pyetja: Në cilin ligj, si në atë kushtetues, në kodin penal dhe të procedurës penale thuhej (sanksionohet) që i dënuari politik, përveç dënimit penal (heqje lirie), sekuestri i pasurisë së tundshme dhe të pa-tundshme dhe humbjen e të drejtave elektorale civile (votimi), të shkruej se i burgosuri dënohej me punë të detyruar? Pres përgjigje nga këta zotërinj.

Nejse, po vazhdoj tregimin e filluar, që u bë shkas për këtë shkrim. Kishim disa muaj që ishim



Gëzim Çela

sistemuar në këtë kamp dhe puna e detyruar prej skllëverish vazhdonte përditë.

Po zbrisja nga shkallët e katit të dytë, ku ndodhej stalla që flinim mbi dyshekët e kashtës me nga dy batanije të përdorura për t'u mbuluar, pavarësisht se në dimër bënte shumë ftohtë, kur befasi dëgjoi një zë që bërtet:

- E vranë Kenedin!... E vranë Kenedin!...

Ai zë më ngjante se vinte nga mbretëria e Hadit... I nxitova hapat e zbritjes, gati sa po rrokullise-sha, për të mbërritur në korridorin e ndërtesës, nga vinte ajo britmë, aty ku ndodhej qendra e zërit, altoparlanti i Radio Tiranës dhe përballë saj zyra teknike... U befason kur pashë Rizain dhe Karafilin, që dihej se ishin njerëz të komandës, që vazhdonin të thoshin me zë të lartë: "E vranë Kenedin! E vranë Kenedin!"

U trondita, ngadalësova hapat, frymëmarrja filloi të më mpakje dhe shikimi të më mugëtohej. Ju afrova atyre dhe, me gjysmë zëri, u thashë:

- Është e vërtetë?

- Po, po. Sapo e dha lajmin Radio Tiranë.

Ula kokën dhe vazhdova të eci përgjatë korridorit. Po më dukej vetja si Odisea, kur kalonte ndërmjet Shillës dhe Karibëdës.

Shpejtova hapat për të dalë sa më shpejt në oborr, për t'u lehtësuar nga kjo barrë e rëndë emocionale.

Ishte 22 nëntor 1963.

Pse duhej ta vrisnin atë që ish-



të lajmëtari i një epoke të re, presidenti më i ri i historisë së Amerikës, ai që iu drejtua të rinjve, duke thënë: "Mos prisni se çfarë duhet të bëjë atdheu për ju, por çfarë do të bëni ju për të". Atë që kur u ngjit në podium përballë murit komunist të Berlinit, e la fjalimin e përgatitur dhe iu drejtua gjermanëve, duke thënë: "Unë sot jam një qytetar berlinez". Ai që u përball me superfuqinë hrushoviane për raketat në Kubë dhe fitoi.

Të gjitha këto vërtetëshin në mendjen time dhe gumëzhinin në veshët e mi, ndonëse s'i kisha dëgjuar ndonjëherë, i ndodhur (gjithmonë) prej shumë vitesh nëpër burgje, por kisha pasur rastin t'i lexoja nëpër gazeta dhe revista sovjetike, që nëpër burgje qëllonte që

qarkullonin, përpara prishjes së miqësisë me Bashkimin Sovjetik.

Pasi kishin kaluar disa ditë, më njoftuan se më kishte ardhur nëna për të më takuar. Gjatë takimit, vura re se nëna ishte e shqetësuar:

- Bir, pse nuk rri rehat, por kërkoni t'i sjellësh telashe vetes dhe mua? - tha ajo.

-Pse, mama, m'i thua këto fjalë? - i thashë.

- Krugës, kur po vija, më ndaloi komandanti i kampit dhe më tha: "Djali yt ka qarë për Kenedin. Po ai burri yt që është në Amerikë, a ka qarë për Kenedin?"

U befasona nga këto fjalë.

- Jo, mama, s'është e vërtetë, nuk kam qarë, - i thashë për ta qetësuar:

Kësisoj, ajo e mori pak veten, por u largua nga takimi mjaft e mërzi-

tur. Me pretekstin se gjoja nuk kisha rregulluar mirë dyshekun e kashtës ku flija, më dënuan në një muaj izolim në birucë.

Ky, pra, ishte ndëshkimi për një keqardhje pa zë për vrasjen e Presidentit të Amerikës.

\*\*\*

Kishin kaluar 32 vjet nga vrasja e Kenedit dhe 45 vjet që në Shqipëri, kur kishte ardhur demokracia, pa komunizëm dhe pa burgje dhe internime politike.

Rrethanat e një realiteti që shkapërcen çdo lloj fantazie, e sollë që nëpërmjet të një krushqie, të njihesha me njeriun që jetonte ende dhe e dinte se ku ndodhej varri i tim eti, që kishte ndërruar jetë më 1968, në Philadelphia të SHBA. Kësisoj, po më realizohej një ëndërr e vjetër për të shkuar në tokën e atij vendi, që kishte qenë gjithmonë frymëzimi dhe shpresa jonë.

Takimin e parë me tokën e premtuar e bëra në aeroportin "John Kennedy", në Nju Jork, aty hodha hapin e parë kur zbrita nga aeroplani dhe krahasova hapin tim me atë të Armstrongut, kur zbriti në Hënë, pasi për mua Amerika kishte qenë një ëndërr po aq e largët, siç është Hëna për Tokën.

Midis një pylli në Philadelphia, ndodheshin disa varre shqiptarësh, por gurët e disave me emrat e tyre, ishin rrëzuar, kurse mbi varrin e tim eti kishin mbetur disa gurë, të hedhur grumbull njëri mbi tjetrin, që koha i kishte vjetruar... Ky, pra, ishte varri i babait që mbylli sytë i vetmuar, në një kohë që i biri ndodhej nëpër burgjet e Shqipërisë.

Me një vullnet dhe forcë si të Herkulit, iu përvesha punës për rindërtimin e këtij varri, djersë dhe lot shoqëronin punën time, për të vendosur pllakën dhe një gur me emrin e tij: Mahmut Çela, 1898 - 1968. Dhe mbi atë pllakë varri hodha disa lule që i kisha sjellë nga toka e atdheut tim, aroma e të cilave atij i kishte munguar për shumë vjet.

Të nesërmen u nisa për në Washington, për të një tjetër varr, të cilin e krahasoja po me atë të tim eti, të Xhon Kenedit, për të cilin kisha bërë një muaj izolim në birucë...

Por në Washington, para kësaj pllake varri nuk kisha pse të druhesha, nëse do të shfaqja keqardhje, deri në dërdhje lotësh.

(Marrë nga libri "Nga burgu Spaçit drejt lirisë")

3 mijë studentë e 83 persona të stafit votojnë, kush do e zëvendësojë Dukën

Voltiza Duro

# Zgjedhjet për dekanin e FHF, ja emrat që garojnë për postin

## Kush do të jenë shefat e rinj të departamenteve

Në Fakultetin e Histori-Filologjisë mbahen sot zgjedhjet e parakohshme, të cilat do të përcaktojnë se kush do të jetë dekan i ri në krye të këtij fakulteti. Burime nga Rektorati i Universitetit të Tiranës, bëjnë me dije për "Gazeta Shqiptare" se dy kandidatët që do të garojnë për këtë pozicion janë prof.dr Aljula Jubani dhe prof.dr Sabri Laçi. Gjithashtu, burimet thonë se janë plot 83 persona, pjesë e stafit të këtij fakulteti, që do të votojnë sot për të zgjedhur dekanin. Këto zgjedhje të parakohshme, po zhvillohen për shkak se dekania e mëparshme, që ishte në krye të Fakultetit të Histori-Filologjisë, u tërhoq nga posti, pasi u përzgjedh deputete në Kuvendin e Shqipërisë. Ndërkaq në zgjedhje do të marrin pjesë edhe 3 mijë studentë, të cilët në faqen zyrtare të fakultetit, mund të informohen mbi rregulloren që duhet zbatuar gjatë procesit të votimit. Këto zgjedhje po mbahen me urdhrin e brendshëm të firmosur nga rektori i Universitetit të Tiranës, Mynyr Koni në datën 31 tetor të këtij viti ku bëhet me dije se zgjedhjet e parakohshme do të zhvillohen për disa autoritete drejtuese në UT. Respektivisht



Prof.dr Sabri Laçi



Prof.dr Aljula Jubani

nëpërmjet zgjedhjeve do të përcaktohet: Dekani i Fakultetit të Histori-Filologjisë, përgjegjësi i Departamentit të Gjuhës në këtë fakultet, përgjegjësi i Departamentit të Gjuhës Spanjolle në

Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, përgjegjësi i Departamentit të Statistikë-Informatikës së zbatuar në Fakultetin e Ekonomisë e Përgjegjësin e Departamentit të Kimisë në Fakul-

tetin e Shkencave të Natyrës. Sot do të përcaktohet edhe përgjegjësi i Departamentit të Sociologjisë dhe përgjegjësi i Departamentit të Shkencave Politike në Fakultetin e Shkencave So-

cialë. "Data e zhvillimit të zgjedhjeve të parakohshme për autoritetet drejtuese të sipërpërmendura, do të jetë data 7 dhjetor 2017. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Komisioni Institucio-

nal i Zgjedhjeve (KIZ) si dhe Komisionet e Zgjedhjeve në Fakultetet Përkatesë", citohe në urdhrin e brendshëm të firmosur nga rektori i UT-së, Mynyr Koni. Ndërkaq, edhe posti i zëvendës rektorit të Universitetit të Tiranës, të cilin e ka mbajtur Shezai Rrokaj ka mbetur bosh. Gjithashtu, Komisioni Zgjedhor i Fakultetit ka publikuar udhëzimin mbi procedurat e votimit që do të kryhen nga studentët ditën e sotme. Në këtë udhëzim theksohet se para votimit, studenti duhet të paraqesë kartën e identitetit apo pasaportën. "Në qendrën e votimit ndalohet kategorikisht përdorimi i aparateve celulare apo i mjeteve të tjerë regjistruar nga ana e studentëve votues. Studenti duhet të hyjë në dhomën e fshhtë i pangarkuar me çanta, mjete apo sende, qoftë edhe shkollore", - thuhet në udhëzimin e Komisionit Zgjedhor të Fakultetit.

### Lindita Nikolla: Të vazhdojmë të kontribuojmë

Përmbytjet, ministrja e Arsimit takim me drejtorët e shkollave në ndihmë të të prekurve

Pas situatës së shkaktoar nga përmbytjet e ditëve të fundit, ministrja e Arsimit, Sportit e Rinisë, Lindita Nikolla ka organizuar dje një takim me drejtorët e shkollave të vendit. Synimi i këtij takimi ishte diskutimi mbi situatën e krijuar dhe solidarizimi për t'i ardhur në ndihmë familjeve në nevojë. Ministrja i bëri thirrje të gjithë të pranishmëve në takim për më tepër bashkëpunim e ndërgjegjësim, ndërkaq shtoi se në shenjë kontributi për familjet e prekura nga përmbytjet do të ofrojë rrogën e saj mujore për t'i ardhur në ndihmë sadopak. "Ndihmë shkollave në vështirësi dhe kolegëve tanë. Të kultivojmë solidaritetin dhe ndihmën. Ky është rasti më i mirë që këto vlera t'i kultivojmë", - tha Nikolla. Më tej ajo shtoi se deri më tani disa gjimnaze në vend kanë arritur të mbledhin ndihma për ushqime dhe libra, por theksoi se kon-



Ministrja e Arsimit, Sportit e Rinisë, Lindita Nikolla

#### NDIHMA

"Janë në dispozicion dy numra llogarie ku ne do mundësojmë ndihmën tonë për shkollat që kanë pësuar dëme. Edhe unë do dedikoj rrogën time mujore për familjet. Ndihma juaj është e vyer." - tha Nikolla.

tributet nga ana e të gjithë atyre që kanë mundësi, duhet të vijojnë për të ndih-

muar sadopak banorët e zonave që pësuan përmbytje. "Ndihmë e koordinuar



"Ndihmë shkollave në vështirësi dhe kolegëve tanë. Të kultivojmë solidaritetin dhe ndihmën. Ky është rasti më i mirë që këto vlera t'i kultivojmë"

aty ku ka më shumë nevojë. Janë në dispozicion dy numra llogarie ku ne do mundësojmë ndihmën tonë për shkollat që kanë pësuar dëme. Edhe unë do dedikoj rrogën time mujore për familjet. Ndihma juaj është e vyer.", - u shpreh ministrja e Arsimit gjatë takimit.



### Ndryshimet brenda 300 ditësh

AKU: Ashpërsim i Kodit Penal mbi sigurinë ushqimore

Për një siguri ushqimore më të lartë, pritet të sugjerohen ndryshime në Kodin Penal me qëllim ashpërsimin e ligjit për përmirësimin e punës në këtë sektor. Këto propozime do të bëhen nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, e pritet që ndryshimet të realizohen brenda 300 ditësh, periudhë kjo e cila përkon edhe me përfundimin e vlerësimit të riskut. Ndërkaq, AKU ka kryer verifikime, ndërkohë që së shpejti do të ndërmerret edhe vlerësimi i riskut. Ky i fundit do të evidentojë ato raste ku kjo pjesë e Kodit Penal nuk ka funksionuar e më tej do të vijë edhe propozimet konkrete nga ky autoritet për ndryshimin e tij. Sugjerimet do të kenë për qëllim penalizimin e të gjithë atyre personave që prodhojnë apo importojnë produkte ushqimore të pasigurta e jashtë standardeve të përcaktuara. "Importimi, ruajtja dhe shitja e ushqimeve, pijeve dhe lëndëve të tjera, e barnave të rrezikshme ose të dëmshme për jetën e shëndetin, si dhe futja në prodhimin e kimikateve, materialeve dhe lëndëve shtesë në prodhimin e përpuniminin e artikujve ushqimorë e të pijeve, kur nga këto vepra ka ardhur vdekja ose dëmtimi i rëndë i shëndetit të personit, dënohen me gjobë ose me burgim deri në dhjetë vjet.", citohe në nenin 288 të këtij Kodi Penal. Më tej, theksohet se kur nga vepra është shkaktuar vdekja ose dëmtimi i rëndë i shëndetit të disa personave, dënohet me burgim jo më pak se pesë vjet.


## EKSPOZITA



Ekspozita vjen si një memoriam në ditëlindjen e tij, kur ka vetëm disa muaj që është larguar nga jeta, si një moment për ta kujtuar bukur një personazh që jetoi dhe e deshi të bukurën...

Teksa luhaten në erë, degët e shpërndara të pemëve në vizatimet e Luter Kreshpës duken si një ftesë për reflektim. Arti nuk mund të jetë i fortë nëse nuk ka mendimin brenda, dhe tablotë që Brisejda (e bija) na tregon, pa fshehur trishtimin e ikjes nga portreti, tekta rrëfen historinë e jashtëzakonshme të një njeriu që besoi aq shumë te pasioni, mbarin thellësi. Ato nuk janë thjesht pemë, por gjendje reflektimi të një shoqërie, e cila kërkon të shpëtojë nga kaosi. Të realizuara në kohë të ndryshme, koleksioni i pikturave dhe vizatimeve të lëna pas nga doktor Kreshpja na japin profilin e një artisti, i cili dhe pse ka qëndruar gjithnjë në distancë nga atmosfera e arteve pamore në vend, ka pësuar një proces zhvillimi po aq interesant sa dhe vetë koha. Nën frymën realiste tablotë sjellin fragmente të ndryshme jete, që përshkohen nga emocionet. Ti mund të shohësh gjatë këto tablo, që artisti i ka ndërtuar i vetëm në atë botën e krijuar prej tij të krijimit, nga ku jo vetëm gjente paqen, por dhe kuptimet e jetës. Më 10 dhjetor në ora 11.00 në Muzeun Historik Kombëtar të gjitha këto tablo do të vijnë në ekspozitë e quajtur "Të ndjekësh ëndrrat" me autor dr. Luter Kreshpa. Një ekspozitë që vjen si një memoriam në ditëlindjen e tij, kur ka vetëm disa muaj që është larguar nga jeta, si një moment për ta kujtuar bukur një personazh që jetoi dhe e deshi të bukurën. I lindur më 10 dhjetor 1961 ai do të dashurohej me pikturën herët, për ta ndjekur heshturazi këtë pasion dhe pas mbarimit të studimeve për mjekësi në vitin 1961.

Dy vite më vonë ai aftësohet për kirurg i përgjithshëm. Kirurgjia ishte shkenca ku prof. Kreshpja do të jepte gjithë aftësitë e tij jo vetëm në shërbim të pacientëve, por dhe krijimit të standardeve të reja në mjekësinë shqiptare. Me profilin e një intelektualit par ekselencë ai do të angazhohej në konferenca të shumta, për sa i përket Kirurgjisë hepatobiliare, si në Francë, Greqi, apo udhëtimi për në Vietnam më 1986-tën. Ka mbrojtur në 1987, dizertacionin për doktor shkencash në Kirurgjinë Pulmonare "Trajtimi kirurgjikal i bronkoektazisë". Janë të pafundme leksionet që ai ndërtoi mbi kirurgjinë, duke dhënë një model për brezat që do të vijnë. Është autor i 8 teksteve për sëmundjet kirurgjikale, 19 artikujve në Buletinin e Shkencave Mjekësore (BSHM), 41 artikujve në Punimet Kirurgjikale (PU), 9 artikujve në Revistën Mjekësore (RM) 48 referate dhe kumtesa, 19 recensione dhe oponenca. Është autor i monografisë "HERNIA, Veçoritë klinike dhe mjekimi", botim i vitit 2007. Por ajo që e bënte dr. Luter Kreshpën të ishte ndryshe nga të tjerët, ishte pikërisht artisti brenda tij. Pas tërheqjes nga



## Pikturat, pasioni i bukur i një kirurgu



Në foto:  
Doktor Luter Kreshpja



Ekspozita hapet më 10 dhjetor në Muzeun Historik Kombëtar

profesioni ai iu dedikua pikturës. E bija, kujton kohët e kaluara në Pogradec ku kishte krijuar dhe zakonet e tij me pikturën. Punonte me orë të tëra, i fokusuar i gjithi te bojërat e peizazhi. Indjeshëm ndaj natyrës, ai e reflektonte atë dhe në peizazhet e pafundme që ka lënë pas. Natyra ashtu si piktura duket se ishin pagja për të. Ekspozita që do të hapet në Muzeun Historik Kombëtar mbart një koleksion prej 93 pikturash, kryesisht natyra të qeta dhe peizazhe, por edhe disa portrete e skica. Në këtë ekspozitë janë përzgjedhur disa prej punimeve të autorit të grupuara sipas rubrikave të tij të preferuara natyrë e qete, peizazh, portret dhe skica. Por, kjo ekspozitë na e sjell ndryshe profilin e kirurgut Luter Kreshpja për të gjithë ata që e njihnin. Në të ju do takoni artistin Kreshpja, që ashtu modest e fshehu gjithnjë tek vetja dhe kërkoi ta zbulonte pikërisht në ikje të tij. Brisejda tregon se kjo ekspozitë ishte parashikuar të bëhej më 80-të vjetorin e tij të lindjes, një vit më parë. Ishte vetë artisti që u mor vetë me gjithçka deri te kërkesa drejtuar drejtorit të atëhershëm të Muzeut, Melsi Labi për këtë ekspozitë. "Pavarësisht se, pothuaj gjithë jeta ime, ka qenë intesivisht

në shërbim dhe përkushtim të pacientëve, herë pas here kam gjetur kohën të ushtroj dhe shijoj pasionin tim të madh, pikturën. Piktura ka qenë çlodhja dhe arratia ime nga trysnia e një profesioni të lodhshëm", shkruante ai, duke vijuar se "Koleksioni im modest është përpjekja ime e vazhdueshme për të mos u ndarë nga pasioni im, pasion i cili nuk më la kurrë. Që në fëmijërinë time unë shquhesha në shkollën "Skënderbej" për pikturat, kryesisht bardh e zi. Në shkollë të mesme bëja në perfeksion portretet e shokëve dhe shoqeve të klasës". Kur ishte në vit të katërt në shkollën e mesme do të fitonte konkursin për portretin më të mirë të vizatuar". Koleksioni im është krijuar kryesisht këto 20 vitet e fundit, periudhë ku në çdo ditë të punës time si kirurg përballesha me sfidën e triumfit mbi vdekjen", shkruan ai.

Por ai nuk mundi t'i ngjiste shkallët e Muzeut Historik për të prituri miqtë në ekspozitë e tij të parë personale pas një jete përkushtim në pikturë, duke u ndarë nga jeta vetëm pak para se të hapej ekspozita. Ndaj kjo ekspozitë e bën më të trishtueshëm portretin e Brisejdes, tekta përpiqet të ndërtojë ëndrrën e bukur të të atit.





Table with 4 columns: ID, Name, Address, Date. Rows 118-138.

Table with 4 columns: ID, Name, Address, Date. Rows 139-159.

Table with 4 columns: ID, Name, Address, Date. Rows 160-180.

QARRU VLORE, ZONA KADASTRALE 864 ZVRRP SARANDE

QARRU LEZHE, ZVRRP LEZHE, ZONA KADASTRALE 1842

QARRU DURRES, ZONA KADASTRALE 3542 ZVRRP DURRES

Table with 4 columns: ID, Name, Address, Date. Rows 181-201.

Table with 4 columns: ID, Name, Address, Date. Rows 202-222.

Table with 4 columns: ID, Name, Address, Date. Rows 223-243.

QARRU GJROKASTER, ZONA KADASTRALE 340 ZVRRP GJROKASTER

QARRU LEZHE, ZVRRP LEZHE, ZONA KADASTRALE 8632

QARRU DURRES, ZONA KADASTRALE 3239 ZVRRP DURRES

Table with 4 columns: ID, Name, Address, Date. Rows 244-264.

Table with 4 columns: ID, Name, Address, Date. Rows 265-285.

Table with 4 columns: ID, Name, Address, Date. Rows 286-306.

QARRU GJROKASTER, ZONA KADASTRALE 3719 ZVRRP TEPEDROR

QARRU LEZHE, ZVRRP LEZHE, ZONA KADASTRALE 1847

QARRU DURRES, ZONA KADASTRALE 3240 ZVRRP DURRES

Table with 4 columns: ID, Name, Address, Date. Rows 307-327.

Table with 4 columns: ID, Name, Address, Date. Rows 328-348.

Table with 4 columns: ID, Name, Address, Date. Rows 349-369.

QARRU GJROKASTER, ZONA KADASTRALE 188 ZVRRP PUMPE

QARRU LEZHE, ZVRRP LEZHE, ZONA KADASTRALE 1848

QARRU DURRES, ZONA KADASTRALE 3241 ZVRRP DURRES

Table with 4 columns: ID, Name, Address, Date. Rows 370-390.

Table with 4 columns: ID, Name, Address, Date. Rows 391-411.

Table with 4 columns: ID, Name, Address, Date. Rows 412-432.

QARRU GJROKASTER, ZONA KADASTRALE 2131 ZVRRP PUMPE

QARRU LEZHE, ZVRRP LEZHE, ZONA KADASTRALE 1849

QARRU DURRES, ZONA KADASTRALE 3242 ZVRRP DURRES

Table with 4 columns: ID, Name, Address, Date. Rows 433-453.

Table with 4 columns: ID, Name, Address, Date. Rows 454-474.

Table with 4 columns: ID, Name, Address, Date. Rows 475-495.

QARRU GJROKASTER, ZONA KADASTRALE 3574 ZVRRP TEPEDROR

QARRU LEZHE, ZVRRP LEZHE, ZONA KADASTRALE 1850

QARRU DURRES, ZONA KADASTRALE 3243 ZVRRP DURRES

Table with 4 columns: ID, Name, Address, Date. Rows 496-516.

Table with 4 columns: ID, Name, Address, Date. Rows 517-537.

Table with 4 columns: ID, Name, Address, Date. Rows 538-558.

QARRU GJROKASTER, ZONA KADASTRALE 1873

QARRU LEZHE, ZVRRP LEZHE, ZONA KADASTRALE 1851

QARRU DURRES, ZONA KADASTRALE 3244 ZVRRP DURRES

Table with 4 columns: ID, Name, Address, Date. Rows 559-579.

Table with 4 columns: ID, Name, Address, Date. Rows 580-600.

Table with 4 columns: ID, Name, Address, Date. Rows 601-621.

QARRU GJROKASTER, ZONA KADASTRALE 1877

QARRU LEZHE, ZVRRP LEZHE, ZONA KADASTRALE 1852

QARRU DURRES, ZONA KADASTRALE 3245 ZVRRP DURRES

Table with 4 columns: ID, Name, Address, Date. Rows 622-642.

Table with 4 columns: ID, Name, Address, Date. Rows 643-663.

Table with 4 columns: ID, Name, Address, Date. Rows 664-684.

QARRU GJROKASTER, ZONA KADASTRALE 1878

QARRU LEZHE, ZVRRP LEZHE, ZONA KADASTRALE 1853

QARRU DURRES, ZONA KADASTRALE 3246 ZVRRP DURRES

Table with 4 columns: ID, Name, Address, Date. Rows 685-705.

Table with 4 columns: ID, Name, Address, Date. Rows 706-726.

Table with 4 columns: ID, Name, Address, Date. Rows 727-747.

QARRU GJROKASTER, ZONA KADASTRALE 1879

QARRU LEZHE, ZVRRP LEZHE, ZONA KADASTRALE 1854

QARRU DURRES, ZONA KADASTRALE 3247 ZVRRP DURRES

Table with 4 columns: ID, Name, Address, Date. Rows 748-768.

Table with 4 columns: ID, Name, Address, Date. Rows 769-789.

Table with 4 columns: ID, Name, Address, Date. Rows 790-810.

QARRU GJROKASTER, ZONA KADASTRALE 1880

QARRU LEZHE, ZVRRP LEZHE, ZONA KADASTRALE 1855

QARRU DURRES, ZONA KADASTRALE 3248 ZVRRP DURRES

Table with 4 columns: ID, Name, Address, Date. Rows 811-831.

Table with 4 columns: ID, Name, Address, Date. Rows 832-852.

Table with 4 columns: ID, Name, Address, Date. Rows 853-873.

QARRU GJROKASTER, ZONA KADASTRALE 1881

QARRU LEZHE, ZVRRP LEZHE, ZONA KADASTRALE 1856

QARRU DURRES, ZONA KADASTRALE 3249 ZVRRP DURRES

Table with 4 columns: ID, Name, Address, Date. Rows 874-894.

Table with 4 columns: ID, Name, Address, Date. Rows 895-915.

Table with 4 columns: ID, Name, Address, Date. Rows 916-936.

QARRU GJROKASTER, ZONA KADASTRALE 1882

QARRU LEZHE, ZVRRP LEZHE, ZONA KADASTRALE 1857

QARRU DURRES, ZONA KADASTRALE 3250 ZVRRP DURRES

Table with 4 columns: ID, Name, Address, Date. Rows 937-957.

Table with 4 columns: ID, Name, Address, Date. Rows 958-978.

Table with 4 columns: ID, Name, Address, Date. Rows 979-999.

Table with 4 columns: ID, Name, Address, and Status. Rows include property owners like ADEM HYSEN LOKA, AGIM ADD BRASHAJ, and others.

Table with 4 columns: ID, Name, Address, and Status. Rows include property owners like RIFAT HAKO VED, RUDENI HAJI LAPUSHI, and others.

Table with 4 columns: ID, Name, Address, and Status. Rows include property owners like BEHAR, SALEMAN, BURKARTI, and others.

Table with multiple columns: ID, Name, Address, Date, Status, and Area. Rows include individuals like NEKI REKAT, BEKIR REKAT, HASAN SALI, etc.

Table with multiple columns: ID, Name, Address, Date, Status, and Area. Rows include individuals like MEKVI ISUF, RAMAZAN AHMET, XHUMET RAMAZAN, etc.

Table with multiple columns: ID, Name, Address, Date, Status, and Area. Rows include individuals like GJYLUE GJML, PERPARIM RAKIP, GJYLUE GJML, etc.

70 PRONARET QE MARRIN KOMPENSIMIN

Table with columns: Emër, Adesi, Mbledhur, Nr. i pasurisë, Masa e kompensimit (ml. opt), Cënim (shk./m²), Shuma - Vlera e kompensimit (ml), and Seksioni / Vepori. Rows include individuals like HALL REKHEP, BARRI ZEJNEL, HALL REKHEP, etc.

Table with columns: Emër, Adesi, Mbledhur, Nr. i pasurisë, Masa e kompensimit (ml. opt), Cënim (shk./m²), Shuma - Vlera e kompensimit (ml), and Seksioni / Vepori. Rows include individuals like ANDUELA, BAPTSHA, BESIM, etc.

Table with columns: Emër, Adesi, Mbledhur, Nr. i pasurisë, Masa e kompensimit (ml. opt), Cënim (shk./m²), Shuma - Vlera e kompensimit (ml), and Seksioni / Vepori. Rows include individuals like HAXHI, LIRE, NAZE, etc.

Opinion i Ditës

# Roli i ndërkombëtarëve në tranzicionin e Shqipërisë

Nga Bernd Borchardt

(Vijon nga faja e parë)

... të ndërtohej një rrugë e re. Një demonstratë e tillë është e drejtë civile, që ushtrohet nga qytetarët anembanë botës. Por, kjo demonstratë nuk u zhvillua përpara zyrës së bashkisë apo Kryeministrit; ajo u organizua përballë Ambasadës së Shteteve të Bashkuara. Kjo është e pazakontë. Madje, hedh dritë mbi temën e konferencës së sotme "Roli i ndërkombëtarëve gjatë tranzicionit në Shqipëri", një rol që duket të jetë i veçantë këtu në Shqipëri, një rol i cili është humtuar pak prej akademikëve vendas dhe të huaj.

Në të njëjtën kohë, kjo konferencë në kujton 20 vitet e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, si pjesë e kontributit ndërkombëtar në tranzicionin shqiptar: 20 vite gjatë të cilave ka ndodhur një zhvillim rrenjësor. Vetëm 20 vjet më parë, Franz Vranitzky dhe Prezenca e OSBE-së erdhën këtu për të mbështetur rindërtimin e Shqipërisë. Sot jemi shumë larg nivelit të atyre ditëve. Shqipëria ka ecur shumë përpara, por mbeten ende sfida të mëdha.

Njëkohësisht, ky vend na kujton ditë me rëndësi të jashtëzakonshme në historinë e vonë të Shqipërisë. Pikërisht këtu u organizua dhe filloi greva e urisë e studentëve. Ishte këtu ku nisi revolta kundër regjimit komunist. Për këtë arsye, ky vend quhet salla "Liria".

Në vitin 2012, një studiu gjermano-bullgar publikoi një punim me titullin e konferencës sonë. Nëntitulli ishte: "Urë mbi ujërat e trazuarat?", besoj një aluzion për ujërat e trazuarat të politikës shqiptare. Punimi përqendrohej tek efektiviteti dhe efikasiteti i "faktorit ndërkombëtar" në Shqipëri, por edhe e përkrahur rolin e këtij faktori si përpjesëtimor. Aty rekomandohej që aktorët ndërkombëtarë të mos shërbejnë si arbitra të rivalitetëve të politikës shqiptare. Ata duhet të dërgojnë mesazhe të qarta se demokracia e qëndrueshme bazohet në besim në arbitrat shqiptarë dhe jo në arbitrazhin ndërkombëtar. Edhe 6 vite pas publikimit të këtij punimi, këto rekomandime duket se janë ende të vlefshme dhe të pabëra realitet. Nga ana tjetër, shumë anketime - dhe besoj se edhe rezultatet zgjedhore të popullistëve në shumë pjesë të Evropës - tregojnë se, në shumë pjesë të Evropës, "besimi" tek arbitrat kombëtarë ka pësuar rënie. Elektorati i dëgjon gjithnjë e më pak politikanët, ndërsa media është bërë "Luengenpresse", sikurse quhet në Gjermani, shtyp-i i gjenjshtrës.

Bjerrjen e besimit tek institucionet, anketimet ua faturojnë mangësi në komunikimin ndërmjet institucioneve dhe



zgjedhësve, si edhe perceptimit se elitat janë të pandershme. Elitat pretendojnë se ka përmirësim, se ka përparim në horizont, por njerëzve ndryshe u duket situata. Ata ndiejnë se frikërat dhe ankthet e tyre nuk merren parasysh. Në sytë e shumë njerëzve, elitave u mungon vullneti dhe/ose aftësia për një dialog real dhe të qenësishëm me popullin që përfaqësojnë.

Mos është Shqipëria një rast paska ekstrem i kësaj situatë?

Cilat janë specificat e Shqipërisë? Sikurse thashë, studimet kanë qenë të pakta. A kishte të drejtë gazetari i mirënjohur, Mustafa Nano kur shkruante vetëm disa ditë më parë se shqiptarët ose po e lënë vendin, ose presin që këtu ta bëjnë ndryshimin të huaj, ambasadorët? Apo, a është vepërimitaria intensive diplomatike thjesht rezultat i viteve '90 dhe fazave të tjera të shekullit të kaluar, ku Ballkani prodhoi mungesë stabiliteti? Këto janë pyetje të hapura.

Për të filluar shqyrtimin e këtij fenomeni, ne kemi ftuar sot dësh-

mitarë të kohës, vendës dhe ndërkombëtarë, me profil të lartë, të cilët kanë luajtur rol gjatë fazave specifike të tranzicionit në Shqipëri. Me shumë kureshtje pres të mësoj se si e gjykojnë ata tani "rolin e ndërkombëtarëve": që nga mësimja e ambasadares në vitin 1990, në ditë e para të demokracisë, duke vazhduar me trazirat e '97-ës, apo të deklarata e Selanikut e BE-së në vitin 2003, e më tej.

Gjithashtu, kemi ftuar akademikë shqiptarë e të huaj që të paraqesin analizën e tyre në lidhje me këtë rol në fusha specifike të tranzicionit në Shqipëri.

Me këtë konferencë synojmë tri qëllime:

Së pari, shpresojmë të nxisim studiuesit shqiptarë dhe të tjerë që të analizojnë më thellësisht rolin e ndërkombëtarëve këtu. Diplomtat në Shqipëri e krijojnë këtë rol kaq të dukshëm rastësisht, apo thjesht sepse munden? Apo shtyhen prej aktorëve vendës që të marrin këtë rol? A ekziston një ndërlikim mes besimit tek elitat shqiptare dhe qasjes së aktorëve ndërkombëtarë? Mund të ngrihen

edhe supozime të tjera.

Së dyti, duam që në këtë debat të sjellim jo vetëm kontributin e akademikëve, por edhe të dëshmitarëve të kohës.

Së treti, bazuar në këto kontribute, duam të frymëzojmë edhe një debat politik: a duhet shqiptarët të demonstrojnë para Ambasadës së SHBA-ve që zëri i tyre të dëgjohej? Apo, a është mungesa e besimit tek institucionet kombëtare kaq e thellë, sa që ndryshimet për mirë priten vetëm nga jashtë Shqipërisë? Ku i ka rrenjëtin roli i fortë i "ndërkombëtarëve" në Shqipëri, a ka një historik të gjatë ky rol, apo u zhvillua thjesht si "urë mbi ujërat e trazuarat" dhe mbi përçarjet e theksuara ndërmjet partive politike në Shqipëri? Kjo konferencë nuk do të gjejë të gjitha përgjigjet, por pres të japë një kontribut domethënës në këtë debat.

**Autori është kryetari i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri**

**Kjo fjalë u mbajt në konferencën "Roli i ndërkombëtarëve në tranzicionin e Shqipërisë"**

## HOROSKOPI

### DASHI

Me Neptunin në shenjë priten gjëra të mira në fushën e dashurisë. Përgatituni të përfiton. Do të keni në maksimum aftësinë tërheqëse dhe aftësinë për të joshur. Jeni duke shkuar drejt një të ardhmeje të shndritshme në dashuri.

### DEMI

Me Hënës përballë Merkurit, priten të kaloni një ndjenjë vështirësie që nuk mund ta shpërfillni lehtë. Bëni kujdes se çfarë thoni dhe sjelljes së papërshtatshme që mund të keni, sepse mund t'ju shkaktojë probleme.

### BINJAKET

Me Plutonin që i bashkohet shenjës suaj, padituria për t'i vënë fre sjelljes suaj në disa raste mund të shkaktojë ndërlikime. Prandaj, veproni me mend. Jupitri mund të bëjë që të keni disa vonesa administrative të bezdisshme. Kini durim dhe mos u dorëzoni!

### GAFORJA

Me Merkurin dhe Jupitern bashkëpunëtorë, mund të angazhoheni për të mbusur disa mungesa njohurish dhe të arrini të përgatitur për një sfidë shumë të pritur profesionale. Me Venusin mik, është e mundur që një krizë në çift të zgjidhet.

### LUANI

Hëna në qiellin tuaj ju sjell emocione të ndryshme. Nga një anë ju do jeni ëndërrimtar dhe të shokëpatur, nga ana tjetër pasionant dhe të angazhuar. Me partnerin mund të keni vështirësi të mirëkuptoheni rreth çështjeve që kanë ngulur në vend.

### VIRGJERESHA

Shqetësimi nuk do të jetë i lehtë për t'u mbajtur nën kontroll. Do të bëjë që marrëdhëniet me të tjerët t'i keni sipas kapriceve të humorit. Qetësohuni! Nuk do të pranoni propozimin e një të njohurit, sepse më vonë do t'i ndiheni në borxh.

### PESHORJA

Me mbështetjen e Hënës do ta pestoni mirë një zgjedhje që do të bëni dhe do t'ia nisni punën. Do t'i tejkaloni situatat e zënkave dhe do të jeni bujarë. E keni kuptuar se për të zgjidhur disa çështje nuk duhet thjesht të mendoni, por edhe duhet të veproni.

### AKREPI

Pozicioni i Hënës do të bëjë që situata të acarohet. Luftojni mendimet e këqija me një shëtitje në park, apo duke dëgjuar muzikën tuaj të preferuar. Mund të bëni njohje të reja të këndshme. Do të përjetoni emocione të bukura.

### SHIGJETARI

Në ambientin që frekuentoni ka persona me të cilët keni të përbashkëta, por duke qenë se jeni i zënë me çështje të përditshme, nuk e kuptoni. Mos endëroni udhëtime dhe ndryshime në vende utopike, nuk është koha të merrni nisim të reja.

### BRICJAPI

Keni dëshirë të vendosni mirëkuptim edhe më të thellë me personin e zëmër, që do t'ju kuptojë menjëherë dhe do t'ju dëgjojë. Keni përkeqim një partner vërtet të veçantë. Do të zmadhoni rrethin e të njohurve dhe do të krijoni kontakte të shumta me njerëz të ditur.

### UJORI

Sot mund të keni mosmarrëveshje me një familjar që ndërhyr në punët tuaja. Nuk keni fare dëshirë t'i thoni sesi doni të sillni. Do të keni pika të përbashkëta me dikë që ka ditur t'ju tërheqë vëmendjen, por nuk do të jetë e lehtë të pajtohemi.

### PESHQIT

Nëse në punë doni të jeni i qetë, përmbajuni në mënyrë të përpiktë rregullave dhe shmangni kundërshtimin e vazhdueshëm të veprimeve të epërëve. Jeni të papërbajshëm edhe për gjërat më të vogla. Organizohuni mirë, pushoni më shumë, zbatituni me miqtë.

Opinion *i* Ditës

Nga Andon Andoni

# Shkolla njëqindvjeçare, drejt mbylljes

(Vijon nga faja e parë)

... një peticion të tyre me të cilën i kërkonin Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë që të mos ia u mbyllte shkollën e fshatit.

Kanë firmosur 145 vetë, thoshin fëmijët.

Njëqindvjeçare, katër, se ai i fundit që firmosi nuk është nga fshati ynë, thoshte një djalosh rreth të dhymbëdhjetave, është nga Suli.

- Po, por ai këtu në fshat te ne punon çdo ditë?

Njëra nga gratë, si tha se ç'pritej të ndodhte pas lajmërimit të parë, që iu kishin bërë autoritetet e arsimit në Bilisht, se: "shkolla nuk i plotësonte numrin e nxënësve dhe do të mbyllej", -tha;

- Vitin tjetër, na shtohen dy fëmijë të klasës së parë. Pa edhe Olimbia po bën çmos që t'i mbushë mendjen të bijës t'ia lërë nipin të vazhdojë shkollën këtu në fshat. Bëhen 19 gjer mot...po edhe ndonjë tjetër, kushedi!?

Ta mbajmë shkollën e Vasil Xhaçkës dhe Kostë Çekrezit, të çelur më 1920. Kushedi. Vjen një ditë dhe kthehen djemtë në fshat. Ja kanë filluar disa. Ku i dihet...

Ikën njerëzia! Ç'të bëjmë? Kaq kemi mbetur...u qa me dhimbje gruaja tjetër dhe vështronin me dyshim sikur unë të isha njeriu që do vendoste nëse mbahej apo mbyllej shkolla e fshatit tim!?

Në këto njëzet e shtatë vite të demokracisë shqiptare, në të gjithë vendin janë mbyllur thuajse gjysma e shkollave që regjistroheshin në fund të viteve 80! E ndërësa në rrethet e veçanta si Kolonja dhe Gjirokastra ka shifra shumë më tronditëse. Në Kolonjë ka pasur 75 shkolla të tria të niveleve të arsimit bazë, fillore, tetëvjeçare dhe të mesme (sipas terminologjisë së asaj kohe) dhe sot ka vetëm 22! Ndërsa në Gjirokastër vetëm për një dhjetëvjeçar, nga viti 2005 dhe deri sot, nga 66 shkolla kanë mbetur vetëm 35. Dihet që arsyeja kryesore është emigrimi dhe lëvizja e popullsisë brenda dhe jashtë vendit, mungesa e infrastrukturës dhe mjediseve shkollore, dhe përqendrimin në qytetet e mëdha të komunitetit të tyre. Për hir të së vërtetës, shumica e shkollave të mbyllura, kanë pasur një histori të lavdishme që në nisje. Shumë syresh me njëqind e ca vite histori. Të lidhur me emrat e patriotëve dhe rilindësve si Naimi në Frashër, Jani Vreto në Postenat, Petro Nini Luarasi në Luaras, Sotir Peci në Dardhë etj. Kanë shkelur në pragun e tyre breza të tërë shqiptarësh. Patriotë dhe luftëtarë të lirisë dhe të prosperitetit të këtij populli.

Njëqind vite më parë, gazetari dhe themeluesi i letërsisë për fëmijë, Vasil Xhaçka e çeli me vetëm 6 nxënës, shkollën e fshatit tim, Ziçishtit që tashmë, edhe pse numëron 16 të tillë është pikëtuar të mbyllet. U çelen me dëshirën e zjarrtë për të mësuar shqip kundër greqishtes dhe turqishtes të deri asaj kohe. Në shkollën e Dardhës, e çelur plot 100 vite më parë, më 1917-të, përpos të tjerave edhe me

përkujdesjen Sotir Peci, ministrit të Arsimit të qeverisë së Lushnjes (30 janar-14 nëntor 1920), Dhespoti nën ndikimin e kishës greke, kishte shkuar dhe mbledhur fshatin për t'iu thënë që po bënin një herezi që kishin hapur shkollën ku të këndohej shqip, "se ja, ju flisnin të gjithë greqisht, punët dhe kurbetin me sëpatën e rëndë e keni me Greqinë?! Pa edhe meshat në kishë i këndonim greqisht!?"

Por kryeplaku i fshatit i ishte kthyer;

-Të drejtë ke hirësi, flasim greqisht, por ëndrrat i shikojmë shqip ama, në gjuhën e memës!

Dhe për fat të keq, sot ëndrra e

tyre është shuar. Prej 17 vitesh, shkolla e parë e Dardhës, është mbyllur dhe dy nxënësit e saj të këtij viti shkollor, i detyrojnë familjet të shpërngulen për nëntë muajt e shkollës, në Drenovë dhe Korçë!!

Më 1902- mësuesi patriot Nuçi Naçi do shkruante, "Si vajta në Lavdar, miqtë më pritën fort bukur si një vëlla...e unë si shqiptar pata marë dhe libra shqip me vehte dhe zura që më të nesëmen e ua mësova çunave të mësontores së Lavdarit "abecenë" shqip; u habita kur pashë se në tre ditë mësuanë që të gjithë të shkruanin dhe të këndonin gjuhën e tyre; për mesonjës

kanë një prift, edhe ai i djegur shqiptar...mësontore nuku kanë dhe nja 3 a 4 që janë në tërë 9 ka-tundarinë, janë në gjuhë greqisht." , Sot në të gjithë fshatrat e zonës, e vetmja shkollë ajo e Lavdarit, më veltmja kolektive, dhe që varet nga Voskopoja, është në plan të mbyllet për të njëjti shkak; mungesën e nxënësve.

Sigurisht, nëse kjo situatë vështrrohet kaq bardhë e zi dhe sipas rregullave të ftohta të ministrisë, do të mbyllet sa e sa shkolla të tilla; ajo e Ziçishtit ku dhanë mësimit Vasil Xhaçka, dhe Rok Jakova, të cilin Kostë Çekrezi e solli nga Kosova më 1921-shin pasi Roku

kishte mbaruar studimet e Larta në Isburg të Austrisë; ajo e Lavdarit ku iu mësonte abecë-në Nuçi Naçi dhe Ilo Mitkë Qafëzezi; ajo e Vrakës ku dha mësim Migjeni...Dhe lexuesi i këtij shkrimi i "Gazetës Shqiptare" mund të shtojë emra mësuesish të shqipes dhe shkolla të mbyllura pambarrim. Të ndjejnë dhimbje dhe peng për shkollën e vendlindjes, që për hir të kushteve dhe rrethanave, ju janë mbyllur ndër vite, apo janë në prag të mbylljes. Tek i shoh bashkëfshatarët e mi, që hyjnë derë më derë dhe firmosin peticion, për t'ia dërguar ministres së Arsimit, që shkolla e fshatit, me ata 16 nxënës të mbetet e çelur, pasi me të kanë lidhur fatet e tyre të dikurshme dhe të sotme, do kisha dëshirën e zjarrtë, që edhe ata të kishin një shkollë më të madhe me nxënës, me laboratorë dhe internet, me palestër dhe kushte moderne për mësim, zë për të cilën do ta ngrija edhe vetë unë i pari, por ja që nuk është e mundur. Nuk është e mundur edhe për pamundësi e shtetit për t'i grumbulluar në një shkollë cilësore të qytetit a bashkisë, me konvikte e mjedise studimi të standardeve evropiane.

Sigurisht që mund të ketë njëqind arsye për t'i mbyllur, nisur nga argumente të ftohta ligjore, si numri i nxënësve për shkollë, dhe mësues brenda profilit apo jo, por nisur nga e drejta kushtetuese për t'u shkolluar, nga propaganda se kjo qeveri e re është zëri i popullit, dhe qeveri shërbimi, ka plot argumente për t'i mbajtur dhe përpjekur që mos shkojnë drejt rrudhjes dhe rrëgjimit, qoftë edhe përkohësisht, deri sa të krijohen kushte të përshtatshme për shkollim.

Dhe bashkëfshatarët e mi, të gjithë në një zë, kërkojnë mbajtjen e shkollës hapur. Pasi ajo është e lidhur me ta. Me pleqë të plakot që kanë marrë përsipër të mbajnë e të shkollojnë nipërit e mbesat aty, në vendlindje dhe jo kund gjetkë Evropës. Politikat arsimore dhe qeverisëse duhet të jenë të tilla që të shkojë shërbimi te nxënësi dhe jo nxënësi te shërbimi. Të shkojë Muhamedi te mali! Pak janë vërtet fëmijët e një fshati, (katër nxënës në fillore dhe 12 në nëntëvjeçare te ne), por përballë përpjekjeve të zjarrta dhe sakrificave që bëjnë të mëdhenj e të vegjël anë e kënd Shqipërisë, ku rrezikohen të mbyllet shkollat, deri dhe se; "po i mbush mendjen nuses së djalit që t'ia dërgojë nipin vitin tjetër për të bërë shkollën në fshat,?!", nuk mund të ketë arsye për revansh mbyllës. Sigurisht që cilësia në arsimin është një nga gurët e themelit që ka dhe kërkon çdo princ. Kushte të tilla cilësia mund të gjenden nëpër shkollat e qyteteve dhe metropol, dhe një shkollë fshati nuk mund të ngrihet kurrsesi në këto nivele. Kjo është një gjë e njohur. Por gjersa vetë banorët, të ndërgjegjësohen dhe shteti të gjejnë rrugë alternative për shkollimin e fëmijëve të tyre, përkrahja dhe mbështetja ndaj shkollave me rrezik mbyllje, duhet të jetë e pakursyer.





## Italiani dështoi, vëllai i kryeministrit shpalos ambicien

### Partizani-Moxhi drejt divorcit, e zëvendëson Olsi Rama

**T**e Partizani janë të bindur se projekti italian ishte një dështim i madh. I ardhur me shumë bujë në krye të Partizanit, fillimisht si këshilltar i presidentit Demi, e më pas si drejtor i përgjithshëm, pas vetëm 7 muajsh, Luçiano Moxhi është drejt largimit. Ish-Drejtori i Përgjithshëm i Ju-

ventusit pretmoi dhe projektoi një Partizan të madh, por asgjë nuk shkoi sipas parashikimeve të "Big Luçiano-s". Partizani i madh ngeli vetëm në letër, pasi në fushë të kuqe patën nisjen me të keqe të një sezoni në të gjithë historinë e tyre. Një merkato e dështuar në çdo aspekt dhe një trajner

si Mark Juliano, që nuk i dha asnjë impuls skuadrës ishin vetëm pjesa e dukshme e këtij projekti pa vlerë. Shkarkimi i stafit të trajnerit Juliano dhe rikthimi te Starova e kthyen Partizanin në normalitet. Tashmë, pas katyre lëvizjeve pritet që të njëjtin fat të ketë edhe Luçiano Moxhi së bash-

ku me drejtorin sportiv, Antonelo Preiti. Ky lajm konfirmohet edhe nga mediat italiane, që shkruajnë se Luçiano Moxhi është duke kërkuar një tjetër skuadër; këtë herë në Maltë. Kjo ide përforcohet edhe më shumë nga fakti se Partizani e ka gjetur pasuesin e Luçiano Moxhit, vëllain e kryeministrit Edi Rama. Së fundi, Olsi Rama ka filluar dhe kursin për drejtor sportiv dhe së shpejti pritet të marrë zyrarisht këtë post te Partizani.

## SITUATA



### Daja pa sulm në Zvicër, Xhejms mbetet në Tiranë

**S**kënderbeu ka udhëtuar pa sulmues drejt Zvicrës. Nigeriani Xhejms, i vetmi që ka mbetur në gjendje të mirë shëndetësore në radhë të skuadrës korçare, ku mungojnë për dëmtim Soue e Nespor, nuk ka udhëtuar sot me ekipin drejt Zvicrës. Shkak është bërë mospajisja e tij me vizën zvicerane, ashtu si futbollistët e tjerë, një procedurë që klubi shpreson ta zgjidhë nesër në mëngjes, në mënyrë që ai të udhëtojë drejt Bernës, ku zhvillohet ndeshja. Futbollisti ka pasur një problem të ngjashëm në verë para ndeshjes ndaj Mllada Boleslav dhe ndonëse udhëtoi ditën e takimit drejt Republikës Çeke, nuk u aktivizua dhe e pa sfidën si spektator. Tani situata është ndryshe, pasi Skënderbeu nuk ka asnjë sulmues tjetër të mirëfilltë në stol dhe kjo do të detyrojë trajnerin Daja të ndryshojë plotësisht planet e tij dhe të improvizojë për ndërtimin e formacionit për ndeshjen kundër Jang Bojz. Nëse udhëton gjatë ditës së nesërme, pasi të pajiset në kryeqytet me vizën hyrëse në Zvicër, Xhejms pritet t'i bashkohet skuadrës vetëm pak orë para fillimit të takimit, sigurisht jo zgjidhja më optimale para një dueli të tillë.

Skënderbeu luan të fundit në Europë për këtë sezon në transfertën e Bernës

# Kapiteni Shehi: Ta mbyllim me sukses aventurën tonë

## Korçarët sfidojnë Jang Bojz në orën 19:00



Jeton Selimi

**E**dhe pse pa objektiva të mbetura dhe pa sulmuesin kryesor, Ali Soue, Skënderbeu luan ndaj Jang Bojz në Bernë me synimin për të mos dalë pa pikë në ndeshjen e fundit të Europa League. Kapiteni Orges Shehi shpjegon përse rezultati pozitiv do t'i shërbente ekipit për vazhdimësinë në këtë sezon, por edhe për edicionin e ardhshëm. "Duhet të jetë vazhde e paraqitjeve të mira, sepse e kemi nisur shumë shpejt dhe ecuria ka qenë mjaft pozitive. Ta mbyllim me sukses edhe këtë ndeshje të fundit. Do të ishim të kënaqur të mos dilnim pa pikë, por fitorja na bën shumë mirë për moral, ta përfundojmë mirë grupin, pa shërben për koeficientin për renditjen kur hidhet shorti. Suksesi sjell shumë të mira dhe shpresojmë të dalim me pikë". Pavarësisht eliminimit të parakohshëm në grupe, portieri e vlerëson paraqitjen e Skënderbeut përballë rivalëve me emër dhe

buxhet më të madh në arenën ndërkombëtare. "Keqardhje nuk ka. Ndoshta do të ishte tjetër simfoni po të luanim për t'u kualifikuar. Megjithatë, ne kemi bërë shumë mirë në grupe, edhe pse prishmëritë ishin të mëdha dhe kemi synuar ta kalonim grupin. Kemi arritur një standard që i bën shumë mirë futbollit sh-



qiptar, duke u paraqitur si të barabartë me çdo kundërshtar, pavarësisht se rivalët kanë qenë ndoshta pak më

lart se ne, si nga buxheti ashtu edhe nga përbërja. Kjo të bën të mos ndihesh inferior". Me ndeshjen e fundit euro-

piane për t'u luajtur, korçarët nuk e heqin vëmendjen nga kampionati. Edhe pse duken pa rivalë në garën për titull, te Skënderbeu nuk i lejojnë vetes asnjë moment shpërqendrimi. "Sigurisht që pikët dhe diferenca të bëjnë të ndihesh komod. Por nuk mund ta quajmë kursesi të përfunduar, pasi kampionati është i gjatë, ende nuk ka kaluar gjysma. Ecuria e mirë vjen si vazhdimësi edhe e Europës. Po t'i kapësh në total kemi bërë dy kampionate, me 14 ndeshje në Europa League dhe pothuajse aq në kampionat. Vazhdimësia ka qenë e njëtrajtshme, në kampionat dhe Europë. Kemi bërë mirë, kemi diferencë të konsiderueshme pikësh, por kampionati dhe klasifikimi janë të tilla, që me një ndeshje ndryshohen pozicionet".

## Ish-trajneri kuqezi mund të kthehet në Serinë A

### De Biazi dhe Zenga, duel për stolin e Krotones



vënë menjëherë në kërkim të zëvendësuesi dhe brenda ditës së nesërme pritet të zgjidhë mes kandidatave që i janë ofruar apo që klubi ka kontaktuar vetë. Ekspertët e merkatos ital-

iane insistojnë se emrat më të mundshëm janë ato të Di Karlos, Kolantuonos, De Biazit dhe Zengës. Edhe pse ish-trajneri i përfaqësueses shqiptare kishte deklaruar në të kaluarën se preferon-

te të qëndronte larg Italisë, një paraqitje e mirë në stolin e Krotones mund t'i hapte përsëri rrugë teknikut për t'u bërë pjesë e futbollit të rëndësishëm evropian.

## CHAMPIONS LEAGUE

### TË MËRKURËN


GRUPI E	
Liverpul - Spartak Moskë	7-0
Maribor - Sevija	1-1
GRUPI F	
Fejrnord - Napoli	2-1
Shakhtar - Man. Siti	2-1
GRUPI G	
Porto - Monaco	5-2
Lajpcing - Beshiktash	1-2
GRUPI H	
Real Madrid - Borussia	3-2
Tottenham - APOEL Nikosia	3-0

## MBYLLEN GRUPET

### Plotësohen 16 biletat, Napoli e Borussia mbeten jashtë

**T**eksa u mbyll edhe gjithë faza e grupeve në Ligën e Kampioneve, mori formë edhe lista me skuadrat që do të vazhdojnë rrugëtimin për trofeun me veshë të gjata. 8 ekipetë të kualifikuara zyrtarisht ditën e martë, i shtohen edhe 8 të tjera nga 4 grupet e natës së sotme. Në grupin E, Liverpuli dhe Sevija, ia dolën të siguronin nga një biletë për në fazën tjetër. Grupi F pa Napoli që të mbeste në vendin e tretë, ndërsa Manchester Siti zuri vendin e parë, dhe Shakhtari i Donjetskut doli i dyti në grup. Beshiktashi dhe Porto ishin skuadrat e kualifikuara nga grupi G, ndërsa grupi H i kishte mbyllur llogaritë që më parë, me Tottenhamin dhe Realin që zunë përkatësisht vendin e parë dhe të dytë, ndërsa Dortmundi do të vazhdojë aventurën në Europa Ligë. Ja lista me të gjitha ekipet e kualifikuara: Manchester Junajtid, Bazel, PSG, Bajern Mynih, Roma, Çelsi, Barcelona, Juventus, Liverpul, Sevija, Manchester Siti, Shakhtar Donjetsk, Beshiktash, Porto, Tottenham, Real Madrid.

**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

1. Bëjnë arte me re.
2. Krijoi Arsene Lupin (inic).
3. Janë forma.
10. Në hyrje të plazhit.
11. Kapen të parat.
13. Janë ufot.
14. Mbahen nga ata që i thyejnë.
18. Inicialet e Mascagni-t.
19. Në krye të trupave.
20. Eshhtë edhe ai i Këngëve dhe valleve.
22. Pak hemorragji.
23. U shkrua nga Jack London.
25. Institucione Ndërkombëtare Europiane.
26. Scarlet e Bashkë me erën.
27. Janë tituj në ekran.
29. Eric aktor.
31. Kështu e ka syrin vigjilent
32. Janë nofka.
35. Një provë... intelligence.
37. Mund të jenë me sahat.

38. Një pjesë e naivitetit.
40. Pak imagjinatë.
42. Pikat pa kufij
43. Fillojnë aksionin.
44. Kërkohe nga poetët.
47. Nota e diapazonit.
48. I prin kolonës.
51. Eshhtë filozofie moralit.
52. Ulet në dhomën e lartë.

**VERTIKAL**

1. Malet pa kufij.
2. Janë banorë imagjinarë të planetit të kuq.
4. Inicialet e Altman.
5. Një sportist që arrin majat
6. Courier ish-kampion i tenisit.
7. Fillojnë testin.
8. Mund të jetë paraboliqe.
9. Bie me ballë.
10. Carnera, ish-kampion i ringut.
11. Lidhet mes punëtorit dhe punëdhënësit
12. I kanë rrenjë në tokë.

**Fjalëkryqi (2)**


**HORIZONTAL**

1. Patricia këngëtare.
5. I vocërr ai i Migjenit
9. Hari spiune.
12. Qyteti i Robespierre.
14. Phineas i famshëm i cirkut.
16. Pak latinisht.
17. Inicilet e Banderas.
19. Janë tek në rrota.
20. Pak efikasitet.
22. Eshhtë shkolla fillore.
24. Arrihet duke aderuar
27. Pak iniciativë.
28. Një... art i Don Judd.
29. U kompozua nga Rachmaninov.
31. Diku në qendër.
32. Një është për të lidhur.
33. Jepet për hartim.
35. Sergej, poet i famshëm rus.
37. Veriu pa kufij.


39. Mbyllin një tender.
41. Një pjesë analogjisë.
42. Mjeku pa ju.
43. Nisin nga kreu.
44. Një racë kombi.
46. Një rapper i famshëm.
49. Një pikë... vaji.
50. Në fund majtas.
51. Ndizen me një çelës.
53. Emri i Delon
54. Janë të dërguar specialë

**VERETIKAL**


1. Eshhtë edhe ai i sheqerit.
2. Eshhtë lloj papagalli.
3. Një Pop i Andy Warhol.
4. Sapo fillojnë.
6. Qendër në Kubë.
7. Eshhtë pluhuri si Dash.
8. Eshhtë e hollë dhe thërrëse.
9. Fillojnë muzikën.
10. Një kontinent i ri.
11. Eshhtë për medaljen e parë.
13. Kujtohet për një fitore të grekëve ndaj persëve.
15. Provinca e boerëve.
18. Eshhtë qyteti i njëmbinjë dritareve.
21. Eshhtë dukuria.
22. Eshhtë hidrokarbur.
23. Griffith aktore.
25. Qe perëndësia e fitores.
26. Mbeten në fund.
30. Tregon grimin.
34. Këndohet në opera.
36. Para Fe në New Mexico.
37. Eshhtë princ arab.
38. Tony që këndon Quando, quando, quando.
40. Bën mëza.
45. Pak tolerante.
47. Modem pa zë.
48. Pak marramendëse.
50. Mbyllin një dyqan.
52. Fillojnë teorikisht.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

3				2		6	4
	1	7	8				5
		8	6	9		3	
5	3	9	4	8			
	2					7	
			5	1	4	9	3
	7		1	6	2		
8			4	1	5		
9	5		7				6

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

9	5	7	1	6	2	3	4	8
4	6	3	7	9	8	1	2	5
2	8	1	3	4	5	6	9	7
5	7	2	4	3	1	9	8	6
1	3	8	9	2	6	7	5	4
6	9	4	5	8	7	2	1	3
8	4	6	2	1	3	5	7	9
3	1	5	8	7	9	4	6	2
7	2	9	6	5	4	8	3	1

*Argëtim filozofik*

"Kur të ketë kaluar stuhia, nuk do të mbash mend se si ja dole apo si mbijetove. As nuk do të jesh i sigurtë nëse stuhia ka kaluar me të vërtetë. Një gjë e vetme është e sigurtë. Sapo të ketë kaluar stuhia, ti nuk do të jesh më kurrë i njëjti person me atë që ishe para se të fillonte stuhia."

Haruki Murakami

- Mos iu drejto me ton të ashpër ndokujt. Atyre që do ju drejtohesh kështu mund të të përgjigjen në të njëjten mënyrë: plagët janë të dhimbshme; njëra pas tjetrës do bien mbi ty.

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**

Përgjigja e numrit të djeshëm

4	1	9	2	10	19	6	5	4	5	3	19				
6	4	1	3		11				3	T	4	R	18	J	14
13		4		3	2	4	3	2	4	5	3				
7	2	9	5	4	6	5	4	5	3		18				
13	5	11	6	4	5	10	3	5	3		14	4			
19			3	2	16	1	4		2	3	2				
7	4	6	14	5		2				1	11	5			
8	11	1	6	11	14		4	2	18	11					
3	2	10	3	2	11	6		18	4	4	2				
18	8		4		5	7	6	14	6	3	5				
15	2	3	2	11		2	11	6	5	10	5	3			
5	3	2	14	2	3		7	2	3	5	3	6			

P	U	S	I	K	U	P	T	O	P		
U	R	A	R	O	A	S	L	I			
S	I	P	E	L	E	R	I	N	A	T	
H	P	A	N	O	R	A	M	A	T		
T	R	I	P	A	N	O	Z	O	M	A	
E	P	A	T	A	T	I	N	A	T		
T	E	S	A	I	T	T	O	D			
I	A	R	E	S	P	R	A	N	I	M	E
R	I	C	H	T	E	R	S	I	L		
S	T	I	L	E	T	E	U	K	E		
R	U	Z	A	T	R	E					
R	I	C	H	A	R	D	T	A			

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQVE TË NUMRIT TË KALUAR**

A	P	M	P	K	A	G	I	M				
T	I	K	M	O	D	E	L	E	T	R	I	
K	A	P	I	T	E	N	E	T	R	I	Z	
P	I	R	A	T	E	R	I	A	S	O		
P	A	R	A	K	A	L	I	M	E	T	R	
E	R	C	G	E	R	O	R	A	R	I		
N	O	I	R	E	T	P	E	L	L	E	A	
M	I	T	N	M	A	L	O	R	E	T	A	
L	E	D	S	A	R	A	G	O	N	E	A	
A	T	E	S	O	R	E	S	E	A	T		
N	E	E	S	O	N	O	R	E	S	E	A	T
G	U	T	T	S	O	E	D	I	T	I		

**FJALËKRYQI (1)**

E	D	L	T	E	C	M	A	F	I	A		
C	K	O	P	E	R	R	D	E	R	R		
O	H	A	R	A	D	I	A	M	A	N	T	I
E	P	E	R	D	I	T	S	H	M	E	A	
S	T	A	D	I	U	M	E	T	I	R	A	
D	I	K	A	S	T	E	R	I	R	A		
M	E	N	I	S	A	N						
N	O	T	A	A	S	U	E	L	E	N	A	
O	R	E	T	I	M	A	B	O	N	E		
V	E	S	T	M	O	T	E	N	D			
A	A	M	E	N	E	T	R	E	N	E		
K	A	R	A	K	T	E	R	E	T	T	R	

**FJALËKRYQI (2)**

*Thënie të mëçuara*

- Gjërat më të thjeshta janë njëkohësisht edhe më të jashtëzakonshmet, vetëm të mëçuorit mund t'i shohin ato.
- Jeta është si një piano. Butonat e bardhë janë momentet e lumtura dhe butonat e zinj janë momentet e trishtuara... Por mos harroni që përdoren të gjithë butonat së bashku për të krijuar një muzikë të ëmbël që quhet "jetë"...!
- Thellohuni vetëm të njëra. Cila? Te dhembshuria e madhe. Kushdo që ka shumë dhembshuri, ka të gjitha cilësitë e Budës në pëllëmbën e dorës.
- Lëviz nëpër botë duke festuar, kërcyer, kënduar, si një blëte; shko nga lulja në lule, vetëm duke provuar të gjitha eksperiencat, piqesh.

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

# GAZETA SHQIPTARE

# GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

# GSH

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

## GAZETA SHQIPTARE



## Tashmë edhe lundroni!

